



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Nr. Prot. _____

648/12


Tiranë, më 18/2021

Miratohet

KRYETAR

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE
“Efektiviteti i shërbimit të Institucioneve të
Ekzekutimit të Vendimeve Penale”

ARBEN SHEHU





◀PËRMBAJTJA

1. RËNDËSIA E AUDITIMIT	6
1.1 Konteksti i problemit social	6
1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës	7
1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë	8
1.4 Subjektet nën auditim	8
1.4.1 Hyrje	8
1.4.2 Politikat e institucioneve	9
1.4.3 Peshat në buxhet	10
1.4.4 Risqet e aktivitetit të subjekteve	12
1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjekteve	13
1.4.6 Feedback-u i subjekteve gjatë auditimit	13
2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT	15
2.1 Objektivi dhe problemi i performancës	15
2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës	15
2.1.2 Objektivi i auditimit	16
2.2 Përkufizimet dhe terminologjia	17
2.3 Burime të Kriteve	17
2.3.1 Kriteret e politikës	17
2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit	17
2.3.3 Kriteret teknike	18
2.3.4 Kriteret e tjera/Praktikat më të mira	18
2.5 Skema e Auditimit	21
2.5.1 Qasja/metodologjia e auditimit	21
2.5.2 Metodatat/teknikat audituese	21
2.6 Rezultatet e parashikuara	21
2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë	21
2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit	22
2.6.3 Forma e publikimit	22
3. SHITJELLIMI I PIRAMIDËS SË PYETJEVE TË AUDITIMIT	23
3.1 A ofron sistemi i IEVP-ve kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore të përshtatshme për realizimin e objektivave institucionale dhe strategjike?	23
3.1.1 A kanë IEVP-të burime njerëzore të mjaftueshme për të realizuar shërbimet institucionale?	23
3.1.2 A zotërojnë IEVP-të infrastrukturë në përputhje me standardet?	30
3.2 A ofrojnë IEVP-të programe efektive në përputhje me kuadrin rregullator dhe organizativ?	34
3.2.1 A janë efektive programet e punësimit në sistemin penitenciar?	34
3.2.2 A ofrojnë programet e edukimit siguri për riintegrimin në shoqëri të të dënuarve?	38
4. PËRMBLEDHJE	42
4.1 Përmbledhje e konkluzioneve dhe rekomandimeve	42
4.2 Aneks	46
5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE	47



RAPORT AUDITIMI

“Efektiviteti i shërbimit të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”

Janar 2021

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr. 648/2, datë 30.09.2020.

Faza studimore e auditimit nisi në datë 02.07.2020 me shkresën për njoftim-fillim auditimi nr. 648; 648/1 prot., dhe përfundoi më datë 29.09.2020.

Faza e terrenit të auditimit nisi në datë 01.10.2020 me Programin e auditimit cituar më lart dhe përfundoi në 15.11.2020.

Projektraporti i auditimit mori formë përfundimtare më 10.12.2020 dhe me shkresat nr. 648/4; 648/5; iu përcoll subjekteve nën auditim, respektivisht: Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Pas respektimit të afatit për observacione nga palët e interesit, subjektet e audituara, konkretisht: Ministria e Drejtësisë jashtë afateve për observacione ka paraqitur komentet e saj mbi projekt-raportin e auditimit nëpërmjet shkresës nr.648/8 prot., datë 22.01.2021, të cilat janë reflektuar në raportin e auditimit;

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur komentet e saj mbi projekt-raportin e auditimit nëpërmjet shkresës nr. 648/7 prot., datë 13.01.2021, e cila ka shprehur vlerësimin për punës audituese si dhe për rekomandimet e lëna mbi përmirësimin e disa procedurave të rëndësishme lidhur me trajtimin dhe menaxhimin e të burgosurve dhe burimeve njerëzore të IEVP-ve;

IEVP Peqin ka shprehur dakortësinë e saj mbi projekt-raportin e auditimit nëpërmjet shkresës nr. 648/6 prot., datë 28.12.2020;

IEVP Rrogozhinë dhe IEVP Vlorë nëpërmjet e-mail zyrtar kanë shprehur vlerësimin rreth këtij materiali dhe dakortësinë për rekomandimet e adresuara mbi çështjen e objekt auditimi.

Grupi i auditimit shqyrtoi me vëmendje argumentimet dhe komentet e subjekteve dhe i reflektoi ato në raportin përfundimtar.

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit:

1. Znj. Miranda Berdo (Përgjegjëse Grupi)
2. Z. Kresi Anastas (Anëtar)

Dosja audituese kaloi në filtrin e Kontrollit të Cilësisë dhe më pas iu përcoll Kryetarit për Vendimin Përfundimtar.



LISTA E TABELAVE

TABELA 1 – INVESTIMET E REFAI IZUARA NË SISTEMIN E BURGJEVE (NË /I FKË)	10
TABELA 2 – KAPACITET E IEVP-VE DHE NIVELET E POPULLIMIT	11
TABELA 3 – BUXHETI I IEVP PEQIN (NË LEK)	12
TABELA 4 – ANALIZA SË OT.....	12
TABELA 5 – KATEGORIZIMI I RISKUT	13
TABELA 6 – MATRICA E DIZENJIMIT TË AUDITIMIT	20
TABELA 7 – SHPËRNDARJA E STAFIT NË SISTEMIN E BURGJEVE.....	23
TABELA 8 – LËVIZJET E STAFIT NË SISTEMIN E BURGJEVE	24
TABELA 9 – POZICIONET VAKANTE NË IEVP PEQIN.....	24
TABELA 10 - POZICIONET VAKANTE NË IEVP VLORË.....	25
TABELA 11 - POZICIONET VAKANTE NË IEVP RROGOZHINË.....	25
TABELA 12 – KAPACITETET PËR TË DËNUARIT	31
TABELA 13 – NUMRI I TË BURGOSURVE TË PUNËSUAR NË IEVP SIPAS VITEVE.....	35
TABELA 14 – NUMRI I INDIVIDËVE PËRSËRITËS.....	40



✂ **LISTA E SHKURTIMEVE**

KLSH	– Kontrolli i Lartë i Shtetit
ISSAI	– Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>International Standards of Supreme Audit Institutions</i>)
INTOSAI	– Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i>)
SËOT	– Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet (<i>Strengths, Eëaknesses, Opportunities, Threats</i>)
MD	– Ministria e Drejtësisë
DPB	– Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
IEVP	– Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
VKM	– Vendim i Këshillit të Ministrave
OKB	– Organizata e Kombeve të Bashkuara
NJQV	– Njësitë e Qeverisjes Vendore



1. RËNDËSIA E AUDITIMIT

Auditimi në përgjithësi ka të bëjë me ekzaminimin sistematik dhe të pavarur të dokumentacionit tërësor të një institucioni, ndërsa auditimi i performancës lidhet me auditimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, dhe synon krahas të tjerave, formalizimin e ekonomisë, mirëmenaxhimin e financave dhe fondeve publike, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe përdorimit të tyre, në luftë me abuzimin dhe shpërdorimin, vjedhjen dhe korrupsionin dhe keqpërdorimin e tyre. Me shtimin e zhvillimeve të reja të cilat sjellin me vete edhe risqe, auditimi i performancës sa vjen edhe bëhet më i rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e interesit publik. Për këtë, Kontrolli i Lartë i Shtetit gjithmonë e më shumë e ka vendosur theksin në rritjen e numrit dhe të cilësisë të auditimeve, veçanërisht atyre të performancës.

KLSH nëpërmjet auditimeve, bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe burimeve natyrore kombëtare, kryerjen në kohë, me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike, etj.¹ Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe EUROSAI, të cilat gjejnë pasqyrim në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022.

Tematika e auditimeve të performancës, nis me përzgjedhjen e propozimeve për auditim që në vitin paraardhës, në zbatim të Manualit të Auditimit të Departamentit të Performancës, i miratuar me urdhrin e Kryetarit të KLSH-së nr. 47, datë 30.04.2015². KLSH, nëpërmjet tematikave të përzgjedhura për auditimet e performancës, synon të jetë i pranishëm në çështjet me interes të lartë publik, e me anë të rekomandimeve për përmirësim të shtojë vlerë për taksapaguesit.

IEVP-të janë një pjesë e rëndësishme dhe integrale e sistemit të drejtësisë penale në çdo shtet. Nëse përdoren në mënyrën e duhur, ato luajnë një rol thelbësor në garantimin e shtetit të së drejtës, duke bërë të mundur që autorët e veprave penale të vuajnë dënimin përkatës. Në rastin më të mirë, IEVP-të duhet të jenë në gjendje të ofrojnë një përvojë humane, e cila krijon mundësi për ata që vuajnë dënimin dhe ndihmon në rehabilitimin e tyre. Në rastin më të keq, ato mund të kthehen në vende të tmerrshme, inkubatorë sëmundjesh apo depo të thjeshta, nga të cilat të burgosurit kthehen në shoqëri të shkatërruar dhe pa mundësi për të ndërtuar një jetë të re³.

Ky auditim ka në fokus shërbimin e ofruar në IEVP, duke përfshirë kujdesin shëndetësor për ata që vuajnë dënimin, veprimtarinë e zhvilluar për rehabilitimin e tyre, etj. Vlerësimi i performancës së këtyre institucioneve është i dobishëm për të parë ndikimin dhe rezultatet e arritura në drejtim të objektivave strategjike. Ky auditim shërben edhe për të parë politikat dhe zbatimin e tyre në drejtimin të përmirësimit të këtij shërbimi.

1.1 Konteksti i problemit social

Siç u përmend më lart, IEVP-të janë një pjesë shumë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë penale në çdo shtet. Në disa vende, legjislacioni që rregullon burgjet daton shumë hershëm, shpesh që në kohërat koloniale. Në Bangladesh, për shembull burgjet ende funksionojnë në përputhje me kodin e burgjeve të Bengalit të vitit 1894 (ndryshuar në vitet 1920)⁴. Dispozitat e tij shumë të hollësishme janë të vjetruara dhe shpesh të parëndësishme, ndërkohë që nuk përfshijnë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Sigurisht që shumë programe për përmirësimin e burgjeve mund të ndërmerren pa pasur nevojë për ndryshime legjislative dhe në të vërtetë modernizimi i ligjit të burgjeve nuk garanton që reformat do të reflektohen në praktikë. Megjithatë, procesi i zhvillimit të një legjislacioni modern të burgjeve mund të sigurojë mundësi për të përmirësuar kushtet dhe shërbimin në to, si dhe përfshirjen e palëve të treta në proces (siç është shoqëria civile).

¹ Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Neni 6.

² Manuali i Auditimit të Performancës.

³ http://justiceandprisons.org/?page_id=5020

⁴ http://justiceandprisons.org/?page_id=5025



Në vendin tonë, aktet në lidhje me sistemin penitenciar datojnë që në vitin 1921 kur Këshilli i Naltë ngarkoi Qeverinë me hartimin e një projektligji për përmirësimin e jetës së të burgosurve⁵. Në vitin 1933 hyri në fuqi Rregullorja e re e burgjeve e miratuar nga Këshilli i Ministrave, e cila shënoi fillimin e një menaxhimi dhe administrimi të burgjeve mbi baza bashkëkohore për kohën. Nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar dhe deri në vitin 1994 burgjet kanë qenë nën administrimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në qershor të vitit 1994 filloi procesi i transferimit të administrimit dhe menaxhimit të burgjeve nën varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i cili përfundoi në qershor të vitit 2007⁶. Gjatë vitit 1998, me asistencën e Këshillit të Evropës dhe të Ministrisë së Drejtësisë italiane, u hartuan dhe u miratuan nga Parlamenti Shqiptar Ligji për Policinë e Burgjeve, Ligji për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe Ligji për Ekzekutimin e Vendimeve Penale. Në vitin 2000, u miratua edhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, e cila përcaktonte procedurat në lidhje me funksionimin dhe menaxhimin e Institucioneve të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale⁷.

Sistemet e burgjeve ekzistojnë dhe veprojnë në kontekste të ndryshme, si në shtete me të ardhura të ulëta, ashtu edhe në ato me të ardhura të larta, si në shtete të brishta, ashtu edhe në shtete të qëndrueshme me qeverisje të pjekur demokratike. Standardet ndërkombëtare e njohin këtë shumëllojshmëri rrethanash, megjithatë diktojnë parimet themelore, bazuar në detyrën e shtetit për të trajtuar njerëzisht të burgosurit dhe për të respektuar dinjitetin e tyre si qenie njerëzore, njëkohësisht duke ruajtur sigurinë e duhur në burgje.

Krahas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, administrata e burgjeve i nënshtrohet një sërë traktatesh, përfshirë Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, si dhe standardeve dhe normave të tilla si Rregullave Standarde për Trajtimin e të Burgosurve, Parimeve Themelore për Trajtimin e të Burgosurve, Rregullave Minimale Standarde të KB për Administrimin e të Drejtësisë për të Mitur, Rregullave të KB për Mbrojtjen e të Miturve të privuar nga Liria, etj. Këto instrumente bëjnë të qartë se ndërsa të burgosurit humbin lirinë e lëvizjes, ata zotërojnë të drejtat e tyre si qenie njerëzore kur janë në burgim. Ata nuk duhet të trajtohen në një mënyrë çnjerëzore ose degraduese, si dhe ndalohen të gjitha format e torturës. Normat ndërkombëtare vendosin standarde për shumicën e aspekteve të jetës në burg duke përfshirë: akomodimin, higjienën, ndriçimin, ajrimin, ushqimin dhe rekreacionin. Gjithashtu, shërbimet e burgut kanë përgjegjësi për të ruajtur të drejtën e të burgosurve për shëndetin.

Me qëllim që IEVP-të të veprojnë në përputhje me të gjithë bazën rregullatore vendase dhe me standardet ndërkombëtare, personeli i burgut duhet të rekrutohet, trajnohet dhe të pajiset me kushte punësimi që i mundëson atij të përmbushë përgjegjësitë e veta sipas standardeve më të larta. Trajnimi joadekuat, kushtet e këqija të punës dhe mungesa e llogaridhënies mund të ndikojnë në performancën e IEVP-ve.

1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të objektivave të parashtruara në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit (ISSAI) dhe praktikave më të mira evropiane, si një ndër sfidat kryesore të tij ka përcaktuar shtimin e numrit të auditimeve të performancës dhe përmirësimin e cilësisë së këtyre auditimeve.

Auditimet e performancës vlerësojnë, nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse, lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100 & 3200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas eksperiencës britanike, dhe praktikat më të mira

⁵ Raport Publik – DPB 2019

⁶ Ibid.

⁷ Ibid.



audituese në Europë, të cilët shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performace.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiensa dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit. Ky auditim i ndihmon institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale të masin rezultatet e tyre, të identifikojnë mangësitë dhe të synojnë përdorimin e metodave dhe mjeteve sa më me efektivitet për rritjen e rezultateve me të njëjtën kosto.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet këtij auditimi synon të bëjë një vlerësim të procedurave dhe situatës konkrete të shërbimit të ofruar në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë

Në zbatim të veprimtarisë audituese të KLSH, në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve janë zhvilluar rregullisht auditime financiare dhe të përputhshmërisë. KLSH ka zhvilluar edhe më parë auditim performace në MD, megjithatë jo të lidhur drejtpërdrejt me çështjen objekt auditimi.

Në vitin 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka zhvilluar një auditim në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Disa nga rekomandimet e lëna lidheshin me:

- rishikimin e strukturës së institucionit, si dhe përditësimet në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, duke e plotësuar dhe harmonizuar me kuadrin ligjor në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm;
- planin e punës së DAB dhe kontrollin e procedurave të prokurimit publik;
- rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit, etj.

Gjatë veprimtarisë së tij, Departamenti i Auditimit të Performancës ka zhvilluar edhe auditime të tjera me karakter social, të cilat mund të mos jenë të lidhura drejtpërdrejt me IEVP.

1.4 Subjektet nën auditim


Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të politikave dhe shërbimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, gjatë kësaj faze të auditimit, grupi ka vendosur të përfshijë si subjekte Ministrinë e Drejtësisë, si institucioni qendror përgjegjës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Kjo e fundit është institucion varësie i MD dhe është e lidhur drejtpërdrejt me çështjen objekt auditimi.

1.4.1 Hyrje

Ministria e Drejtësisë (MD), në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese, ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, *sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale* a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi⁸.

⁸ Rregullore e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”

Figura 1 - Organigrama e pjesshme e MD




Burimi: MD

Përpunoi: Grupi i auditimit KLSH

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i cili ndjek dhe realizon organizimin, drejtimin dhe kontrollin e të gjithë sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale⁹. DPB synon krijimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues duke siguruar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të sigurojnë një trajtim njerëzor të personave me liri të kufizuar dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi.

Figura 2 - Organigrama e Pjesshme e DPB



Burimi: DPB

Përpunoi: Grupi i auditimit KLSH

1.4.2 Politikat e institucioneve

Sistemi i burgjeve është trajtuar nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020 dhe nga Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017-2020.

SKZHI 2015-2020 shqyrton këtë sistem në objektivin strategjik “Reformimi i sistemit të drejtësisë”. Ajo thekson se në institucionet e vuajtjes së dënimit janë përmirësuar kushtet dhe standardet e trajtimit të personave, por ngelet shqetësuese situata e mbipopullimit në to (bazuar në të dhënat e viteve 2007-2015). Në lidhje me sistemin e burgjeve, SKZHI ka listuar tre nën-objektiva strategjike si më poshtë:

- Garantimi i të drejtave themelore personale dhe transformimi i dënimit penal në mundësi për riedukim përmes:

1. Përmirësimit të mëtijshëm të sistemeve të burgimit dhe para-burgimit;
2. Respektimit i standardeve ndërkombëtare në sistemin e vuajtjes së dënimit, duke përfshirë trajtimin e posaçëm të kategorive të ndryshme të të burgosurve;
3. Uljes së shkallës së mbipopullimit në institucionet e vuajtjes së dënimit; dhe
4. Forcimit të politikës sociale përmes veprimeve të synuara për të: (i) zgjeruar arsimin 9-vjeçar në gjithë sistemin e vuajtjes së dënimit⁶¹; (ii) ngritur sektorë të kujdesit të posaçëm për personat me probleme të shëndetit mendor në pesë Institucione të Ekzekutimit të

⁹ Rregullore e brendshme e DPB



Vendimit Penal (IEVP); (ii) hartuar protokolle standarde për përgatitjen për riintegrim pas lirimit, si edhe rritur përfshirjen e të burgosurve në aktivitete që mbështesin riintegrimin e tyre pas lirimit; (iv) ofruar deri në 3.5 orë këshillimi për të burgosur në muaj.

- Përditësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së burgjeve dhe elementëve të sigurisë në sistemet e burgimit dhe paraburgimit në përputhje me standardet dhe konventat ndërkombëtare dhe instalimi i sistemeve të kamerave në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimit dhe gradualisht transformimi i lehtësirave për të miturit në struktura të hapura ose gjysmë të hapura.
- Ngritja e një baze të dhënash elektronike për të burgosurit përmes një sistemi kompjuterik për kërkimin e dosjeve dhe lidhjes on-line të burgjeve lokale me qendrat e ndalimit dhe institucionin qendror dhe Instalimi i një sistemi të bazës së të dhënave për administrimin e informacionit dhe statistikave.

SND 2017-2020 është një strategji ndërsektoriale e fokusuar vetëm në sistemin e drejtësisë. Në këtë dokument, burgjet përmenden në Objektivin 6: Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit. Strategjia rendit nën-objektivat e mëposhtëm në lidhje me çështjen objekt auditimi:

- Përfshirja e të burgosurve në aktivitete punësimi dhe rritja e numrit të aktiviteteve ri-integruese;
- Ulja e mbipopullimit në IEVP-të në përputhje me standardet evropiane;
- Garantimi i mbrojtjes së të drejtave të të ndaluarve/ të burgosurve me probleme të shëndetit mendor.

Te gjithë nën-objektivat e përmendur më lart kanë kritere të matshme, të përcaktuara në planet e veprimit përkatëse dhe maten nëpërmjet të dhënave të raportuara nga institucionet përgjegjëse.

1.4.3 Pesha në buxhet

Gjatë zhvillimit të fazës studimore, me qëllim identifikimin e vlerësimit financiar të problemit social në fokus, grupi i auditimit ka identifikuar shumën monetare të akorduar për subjektet në auditim në lidhje me zërin financiar më të rëndësishëm atë të investimeve në sistemin e burgjeve (llog.230). Kjo sepse nga shpërndarja e buxhetit të DPB në llogaritë financiare si “Paga dhe Shpërblime” (llog.600); “Kontribute për sigurimet” (llog.601); “Shpenzime të tjera operative” (llog.602) dhe “Transferta” (llog.606); llogaria e investimeve prek drejtëspërsëdrejti vlerësimin nga institucionet qendrore mbi objektin në fokus si dhe shërben si indikator për matjen e cilësisë së shërbimit ndaj të dënuarve. Si e tillë prej tabelës më poshtë vërejmë vazhdimësi investimi për periudhën objekt auditimi, ku shpenzimet më të larta e zënë investimet për vitin 2016. Këto shpenzime financiare janë akorduar kryesisht për: blerje pajisje, logjistikë shëndetësore e sistemit të burgjeve, rikonstruksione godinash dhe rritje kapacitetesh, blerje pajisje sigurie, informatizim i kartelave për të dënuarit si dhe studim projektsh për sistemin e burgjeve.


Tabela 1 – Investimet e realizuara në sistemin e burgjeve (në /lekë)

	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Investimet në sistemin e burgjeve	4,634,200	704,905,836	377,929,988	383,243,757	369,888,971

Burimi: DPB

Përpunoi: Grupi i auditimit KLSH

Figura 3 – Investimet e realizuara në sistemin e burgjeve



Për të ofruar bazë krahasimore për taksapaguesit dhe opinionin e gjerë, në tabelën më poshtë po pasqyrojmë kapacitetet e sistemit të burgjeve në vend për periudhën e auditimit, të detajuara sipas numrit të të dënuarve dhe të paraburgosurve për secilin vit.

Tabela 2 – Kapacitetet e IEVP-ve dhe nivelet e popullimit

<i>IEVP-të</i>	Viti 2016			Viti 2017			Viti 2018			Viti 2019			Viti 2020 Korrik		
	Dënuar	Paraburgosur	Kapaciteti	Dënuar	Paraburgosur	Kapaciteti	Dënuar	Paraburgosur	Kapaciteti	Dënuar	Paraburgosur	Kapaciteti	Dënuar	Paraburgosur	Kapaciteti
<i>IEVP Rrogozhinë</i>	296	141	343	255	135	343	261	91	343	305	-	343	257	-	343
<i>IEVP Peqin</i>	667	38	558	590	27	558	578	12	558	305	142	558	301	115	558
<i>IEVP Korçë</i>	294	181	380	273	128	380	266	129	380	254	128	380	236	178	380
<i>IEVP Vlorë</i>	-	144	160	-	137	160	-	107	160	16	127	160	16	112	160

Burimi: DPB, përpunoi: Grupi i auditimit KLSH

Siç shihet, kjo shpërndarje tabelare sipas dinamikës kohore të periudhës objekt auditimi, pasqyron se për IEVP-të subjekte të auditimit, pavarësisht luhatjeve midis të të dënuarve dhe të paraburgosurve, nuk ka asnjë ndryshim të numrit në total të kapacitetit të tyre.

Në të dhënat e siguruarat rishtaz prej subjektit, grupi auditues ka identifikuar në mënyrë eksplicite buxhetin real të IEVP-së Peqin. Në tabelën e mëposhtme identifikohet qartësisht se buxheti në dispozicion të IEVP Peqin për të realizuar detyrat funksionale të tij, ndjek një trend rritës përgjatë periudhës objekt auditimi. Konkretisht prej 315,099,678 lek për vitin 2016 në 383,509,000 lek për vitin 2019, që do të thotë se rritja mesatare e buxhetit llogaritet rreth 21.7%. Me këto të dhëna, ku peshën kryesore e zë buxheti i financuar nga shteti, pritet që IEVP-së Peqin të ketë ofruar efektivitet në rritje të përmbushjes së objektivave institucional si dhe efektivitet ndaj kategorisë shoqërore ndaj së cilës ofron shërbimin penitenciar.



Tabela 3 – Buxheti i IEVP Peqin (në lek)

Emërtimet e situacionit IEVP Peqin	Periudha			
	2016	2017	2018	2019
Paga dhe shpërblime	230,735,800	257,472,000	258,748,000	271,917,000
Kontribute dhe sigur.	38,508,878	42,666,000	43,211,000	45,563,000
Mallra & shërbime të tj.	45,855,000	58,656,750	57,452,876	61,817,000
Transf. për buxh.famil	0	50,000	0	4,212,000
TOTALI	315,099,678	358,844,750	359,411,876	383,509,000

Burimi: IEVP Peqin, përpunoi: Grupi i auditimit KLSH

Duke qartësuar të dhënat e situacionit buxhetor, shpërndarja e tij ofrohet midis llogarisë 600 paga dhe shpërblime, llogarisë 601 kontribute dhe sigurime, 602 Mallra dhe shërbime të tjera si dhe transfertat. Pa diskutim që zëri i pagave në vlerë absolute zë peshën kryesore kundrejt totalit të institucionit për secilin vit konkretisht 73.2 % për vitin 2016 në 70.9% për vitin 2019, ku nëpërmjet tabelës identifikohet qartësisht se rritja e buxhetit të subjektit shoqërohet me rritje më të lartë të llogarisë 600 paga dhe shpërblime. Nisur prej kësaj analize, grupi i auditimit do të identifikoj në fazat e mëtejshme variacionin e vlerësimeve financiare në mënyrë eksplicite edhe për subjektet e tjera të auditimit si dhe duke i krahasuar me sistemin e tërë të burgjeve dhe performancën e përmbyshjes së objektivave.

1.4.4 Risqet e aktivitetit të subjekteve

Risqet e aktivitetit të subjekteve janë ato risqe me të cilat përballen institucionet e audituara për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi që lindin nga aktiviteti i tyre në tërësi, si dhe në lidhje me institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në veçanti. Risqet e aktivitetit të subjekteve janë analizuar dhe evidentuar të klasifikuara fillimisht sipas analizës SWOT: fuqitë, dobësitë, shanset, kërcënimet, detajuar në faktorë të brendshëm dhe të jashtëm.

Tabela 4 – Analiza SWOT

	Fuqitë (S)	Dobësitë (W)
Faktorë të brendshëm	- Studimet dhe raportimet e DPB; - Zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin; - Nënshkrim i marrëveshjeve ndërinstitucionale mbi ri integrimin e të dënuarve.	- Mungesa e një strategjie kombëtare për burgjet për periudhën 2013-2017; - Mungesa e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve; - Mungesa e investimeve infrastrukturore të standardizuara; - Mungesë e analizave financiare mbi kostimin e shërbimit të IEVP-ve; - Mungesë e stafeve drejtuese të IEVP-ve efektive.
	Shanset (O)	Kërcënimet (T)
Faktorë të jashtëm	- Miratimi i Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë 2017-2020; - Miratimi i ligjit të ri; - Burime financimi; - Monitorim dhe raportim tek një sërë institucioneve ndërkombëtare	- Mungesë e auditimeve të performancës specifike për këtë sektor. - Sektori nuk është shumë tërheqës në drejtim të rekrutimeve të stafit; - Mungesa e informatizimit në sistemin ndëshkimor;

Përpunoi: Grupi i auditimit KLSH

Në vijim, grupi i auditimit ka bërë një ndarje intuitive të risqëve të veprimtarisë duke i kategorizuar ata në strategjikë, financiarë, juridikë dhe operacionalë.

Tabela 5 – Kategorizimi i riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Politikat e Institucionit	Risk Strategjik	I Mesëm
2	Reformat strukturore		I Mesëm
3	Kuadri Strategjik		I Mesëm
4	Investimet	Risk Financiar	I Mesëm
5	Forma e financimit		I Mesëm
6	Sistemet e regjistrimit dhe raportimit	Risk Rregullator dhe Juridik	I Lartë
7	Kuadri Ligjor		I Lartë
8	Mungesa e ndarjes së funksioneve	Risk Operacional	I Ulët
9	Staf i pamjaftueshëm		I Mesëm
11	Risqet Procedurale		I Lartë
12	Risqet e Dokumentacionit		I Ulët

Përpunoi: Grupi i auditimit KLSH

1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjekteve

Ministria e Drejtësisë ka një fushë të gjerë veprimtarie, por në lidhje me objektin e këtij auditimi ajo përqendrohet kryesisht në hartim politikash dhe përcakton drejtimit kryesorë të organizimit dhe funksionimit të DPB. Për sa më sipër, MD nxjerr akte nënligjore dhe mbikëqyr zbatimin e tyre në vazhdim. Si shembull mund të përmenden:

- Udhëzimin nr. 103/2014 “Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta personave të dënuar me burgim”;
- Urdhrin nr. 5211/2019 “Për pezullimin e përkohshëm të lejeve shpërblyese”, etj.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve koordinon të gjithë pjesën e funksionimit të IEVP-ve në terren. Gjithë veprimtaria dhe produktet e saj janë të lidhura me çështjen objekt të këtij auditimi. DPB prodhon një *buletin informativ ditor* në lidhje me sistemin e burgjeve, i cili i përcillet Kryeministrit dhe MD. Në këtë kontekst, DPB përgatit çdo vit *Raportin Publik*, i cili përmban informacion të zgjeruar në lidhje me të dhënat, investimet në burgje, sistemin shëndetësor, rehabilitimin e të dënuarve, sigurinë, buxhetin, etj.

Produktet e tjera që dalin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve janë:

- Rregullore të ndryshme (si p.sh. ajo e trajnimit të stafit)
- Planet e Inspektimit në IEVP
- Raportimet pranë Kuvendit dhe institucioneve ndërkombëtare, etj.

Për sa i përket IEVP-ve, ato prodhojnë *programe për të dënuarit, procedura të brendshme, plane masash*, etj. Ato raportojnë të gjitha të dhënat pranë DPB dhe përgatisin çdo vit analiza që pasqyrojnë veprimtarinë e tyre.

1.4.6 Feedback-u i subjekteve gjatë auditimit

MD dhe DPB i janë përgjigjur në kohë kërkesës së grupit të auditimit për takimin prezantues dhe konsultues. Më tej, grupi ka zhvilluar takimin prezantues me të dyja institucionet.

Dërgimi i informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit është bërë brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nga



institucionet nën auditim. MD, DPB dhe IEVP-të e përzgjedhura nga grupi kanë vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar, të shoqëruar edhe me dokumentet përkatëso, kryesisht në format elektronik brenda afatit 1-javor. Grupi ka zhvilluar intervista me personat përgjegjës në DPB dhe IEVP-të Peqin, Vlorë dhe Rrogozhinë, si dhe pyetësorë me të dënuarit.

Përgjithësisht, subjektet nën auditim kanë qenë të disponueshme në garantimin e informacionit dhe dokumenteve të kërkuara. Grupi i auditimit ka zhvilluar takime me anëtarë të ndryshëm të stafit, të cilët janë treguar të gatshëm për vendosjen në dispozicion të çdo dokumenti të nevojshëm.

2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT


2.1 Objektivi dhe problemi i performancës

Skema e shpërndarjes së institucioneve të përfshira në këtë auditim, orientohet si ngaherë në auditimet e performancës, duke bërë pjesë të saj: Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-të Peqin, Vlorë dhe Rrogozhinë. Këto të fundit janë përzgjedhur për nga specifikat e klasifikimit të IEVP-ve dhe problematikat e veçanta që paraqesin, njëkohësisht duke ofruar mundësi krahasimi për grupin e auditimit me IEVP-të e tjera në vazhdim të fazës së terrenit. Reformimi i kuadrit ligjor në harmoni me standardet ndërkombëtare të fushës dhe zbatimi i rekomandimeve të organizmave ndërkombëtare të tilla si Këshilli i Evropës, janë pa diskutim produkt i frymës së bashkëpunimit institucional, por njëherësh objektiv primar i Ministrisë së Drejtësisë. Ndër të tjera Ministria e Drejtësisë vlerëson dhe miraton propozimet financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në funksion të përmbushjes më së miri të detyrimeve dhe objektivave institucional. Janë pikërisht këto objektiva të cilët konkretizohen në veprime eficiente dhe shërbim efektiv që institucionet penitenciare ofrojnë në vend.

Reformimi në sistemin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, do të duhet të fokusohet në trajtimin më të mirë dhe dinjitoz të të dënuarve, referuar kjo sipas Konventave Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqëri të kësaj kategorie, ku sigurisht pjesa e modernizimit të infrastrukturës dhe krijimi i kushteve bashkëkohore të burgjeve është një nga shtyllat kryesore të reformës në sistemin penenciar.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim janë kategori ku të drejtat dhe trajtimet e së cilëve specifikohen në aktet ligjore të posaçme. Këto akte të një natyre të posaçme që synojnë të sanksionojë privimin e disa të drejtave, duhet ti kushtojnë një vend të veçantë edhe pjesës që i takon trajtimit human të tyre, pasi ka të drejta themelore që i përkasin të gjithëve - madje edhe personave që qëndrojnë në burg. Gjatë kryerjes së këtij auditimi performance do të analizojmë shkallën e realizimit të objektivave të planifikuara, pra rezultatet e matura kundrejt synimeve dhe atje ku është e mundur edhe burimet e shpenzuara për të arritur këto objektiva. Kjo do të thotë se vend të rëndësishëm dhe kryesor në këtë auditim do të zërë efektiviteti. Fakti që do të analizohet raporti input – output i procesit të menaxhimit të politikave me qëllim evidentimin e mekanizmat për të rritur eficiencën e shërbimit të IEVP-ve ndaj të dënuarve dhe paraburgosurve, bën që objektiv i këtij auditimi të jetë efienca. Në figurën më poshtë është paraqitur skema input-output e procesit të mirëmenaxhimit të shërbimit të IEVP-ve dhe monitorimit të progresit të tij:

Figura 5 – Skema input-output e procesit



Burimi: Grupi i Auditimit, përpunoi: Grupi i auditimit KLSH

2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës

IEVP-të sipas legjislacionit shqiptar janë institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim, të cilat pavarësisht zhvillimit ekonomik, kulturor, social dhe politik të vendit ato ekzistojnë si të tilla duke qenë pjesë e zhvillimit të realitetit të atij vendi. Shoqëritë e zhvilluara ndër të tjera përcaktohen si të tilla edhe prej mënyrës sesi ligjërisht dhe



praktikisht trajtojnë këtë kategori të shoqërisë. Aktualisht në sistemin tonë penitenciar funksionojnë 23 IEVP, dinamika e përmbajtjes së të cilave për periudhën objekt auditimi është e ndryshme. Si prej evidencave të siguruara nga grupi i auditimit gjatë fazës studimore njëherësh edhe në raportimet zyrtare të DPB, për vitin 2016 në IEVP-të Rrogozhinë ushtrojnë ekzekutimin e vendimit penal 437 persona kundrejt kapacitetit 343 persona, në IEVP Peqin 705 persona nga 558 persona kapaciteti dhe në IEVP Vlorë 144 persona nga 160 persona kapaciteti. Në mënyrë të qartë evidentohet problemi i mbipopullimit të burgjeve trend i cili për IEVP Rrogozhinë dhe Peqin ka vazhduar si i tillë edhe për vitin 2017 dhe vitin 2018. Në këto kushte të sistemit të vuajtjes së dënimit, ofrimi i shërbimeve standarde të trajtimit njerëzor të të burgosurve dhe të ndaluarve bëhet i vështirë, duke lënë vend për reduktim të cilësisë. Detyrimet e organizmave ndërkombëtare në linjën e sfidave që orientojnë zhvillimin e sektorit të drejtësisë në të ardhmen, fokus të veçantë i kushtojnë transformimit të nocionit të dënimit penal në nocionin e mundësive për rehabilitim, nëpërmjet forcimit të programeve rehabilituese komunitare. Objektivat strategjike lidhur me perspektivën e përmirësimit të këtij synimi garantohen përmes forcimit të politikave sociale brenda sistemit të burgjeve me qëllim zgjerimin e arsimit 9-vjeçar, hartimin e protokolleve standarde për përgatitjen për riintegrim pas lirimit, si edhe rritjen e përfshirjes së të burgosurve në aktivitete që mbështesin riintegrimin e tyre pas lirimit, shoqëruar kjo edhe me seanca këshillimi me ta. Garantimi i këtyre të drejtave themelore është domosdoshmëri e institucioneve përgjegjëse për të vendosur në funksion të sistemit të burgjeve mekanizmat për të vepruar drejtë. Sistemi penitenciar në tërësinë e vetë është pa diskutim sistemi që ka nivel shumë të lartë shpenzimesh, sepse nuk prodhojnë mirëfilli produkte apo shërbime, transmetimi i mëtejshëm i të cilave të gjenerojë të ardhura, por indirekt taksapaguesit presin që me realizimin e objektivave financiare të institucioneve përgjegjëse, të burgosurve t'u sigurohen standardet e larta të trajtimit tyre, përditësim i mëtejshëm i infrastrukturës së burgjeve dhe elementëve të sigurisë në sistemet e burgimit dhe paraburgimit në përputhje me standardet dhe konventat ndërkombëtare, ngritjen e një baze të dhënash elektronike për administrimin e informacionit dhe statistikave. Respektimi i të drejtave dhe trajtimi i të dënuarve me burgim dhe të paraburgosur, ndër të tjera përfshin edhe shpërblimin për punën e kryer, termat e konvertimit të së cilit në pagesa financiare apo ditë shlyerje dënimi, janë bërë jo pak herë objekt shqetësimi dhe ankimesh drejtuar institucioneve ligjvënëse, si dhe pranë Avokatit të popullit. E fundit dhe jo më pak e rëndësishmja për nga problemet e etiketuara gjatë fazës studimore, lidhet me formimin dhe profesionalizmin e stafit menaxhues dhe atij policor. Arsimimi, eksperiencia, ciklet e trajnimit të lidhura ngushtësisht me pozicionin si dhe mungesat e theksuara të pozicioneve kyçe të IEVP-ve si mjek, infermier, staf i policisë, financier etj janë shkalla e dytë e ngërçit të IEVP-ve me ndikim të drejtpërdrejtë mbi efektivitetin e realizimit të shërbimit publik ndaj kategorisë specifike. Problemet që grupi i auditimit ka përmendur në kontekstin social, reduktohet nëpërmjet masave konkrete nga Ministria e Drejtësisë si institucioni politikbërës dhe autoriteti kryesor përgjegjës për mbikëqyrjen, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si institucioni në nivel qendror mbi organizimin strategjik si dhe IEVP-të në nivelin operacional dhe taktik të shërbimit. Sa më sipër taksapaguesit i lind e drejta, të kërkojë nga institucionet publike subjekte të këtij auditimi ndërmarrjen e veprimeve të duhura si dhe krijimin e kushteve të nevojshme për qëndrimin dhe zhvillimin individual të të dënuarve dhe paraburgosurve.

2.1.2 Objektivi i auditimit

E drejta e trajtimit njerëzor dhe respektimit të dinjitetit të personit të cilit i është hequr liria, është detyrim demokratik, social dhe Kushtetues¹⁰ i vendit tonë. Mirëpo ofrimi i kushteve dhe shërbimeve për të mundësuar ekzekutim të drejtave të njeriut të barabarta, të paanshme dhe të pavarura, realizohet e garantohet nëpërmjet politikave shtetërore, akteve strategjike dhe legjisllacionit në fuqi. Këto baza së drejtash duhet të jenë të plota dhe të shoqëruara me planeve operationale konkrete dhe

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 28, pika 5



të arritshme që të mund të mbështesin strukturat e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale si dhe të sigurojnë harmonizim ndërinstitucional në përmbushje me këtë synimi. Me qëllim që qeverisja e politikave mbi IEVP-të të shfaqë rritje në ekzekutimin e performancës institucionale si dhe cilësi dhe transparencë kundrejt kostos efektive të realizimit të shërbimit, kontrolli dhe monitorimi në vazhdimësi i zbatueshmërisë së akteve ligjore përbën feedback-un e nevojshëm dhe të domosdoshëm për ministritë përgjegjëse të linjës dhe institucionin e fushës së varësisë.

Për sa më lart, objektivi kryesor i këtij auditimi janë politikat shtetërore për mirëqeverisjen e shërbimit të IEVP-ve ndaj kategorisë shoqërore të dënuar dhe në paraburgim, si dhe veprimtaria e institucioneve përgjegjëse për të siguruar mekanizmat e menaxhimit, administrimit dhe monitorimit të shërbimit kundrejt kostos efektive e tij, për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2019..

2.2 Përkufizimet dhe terminologjia

Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- **“Auditimi i performancës”** përfshin një vlerësim të ekonomicitetit, efektivitetit dhe efikasitetit të veprimtarisë dhe përdorimit të fondeve nga njësi e sektorit publik në përmbushjen e objektivave.
- **“Efektivitet”** është masa në të cilën arrihen objektivat ose lidhja ndërmjet ndikimit të planifikuar dhe ndikimit aktual për një aktivitet të caktuar.
- **“Efikasitet”** është raporti më i mirë ndërmjet rezultateve dhe burimeve të përdorura për arritjen e tyre.
- **“Ekonomicitet”** është minimizimi i kostos së burimeve të përdorura për kryerjen e veprimtarisë, duke ruajtur cilësinë.
- **“I dënuar”** është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale.
- **“I paraburgosur”** është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, ndaj të cilit është marrë masë sigurimi "arrest në burg".
- **“IEVP”** janë institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ku përfshihen paraburgimet dhe institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim.
- **“Masat për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në IEVP”** është tërësia e veprimeve të ligjshme, të cilat duhet të kryhen nga punonjësi i Policisë së Burgjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim garantimin e rendit dhe të sigurisë.
- **“Personel”** është çdo punonjës të administratës në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në IEVP.
- **“Punonjës i Policisë së Burgjeve”** është punonjësi, i cili ushtron detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse ose ekzekutuese për garantimin e rendit e të sigurisë në IEVP dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
- **“Regjim i brendshëm”** janë dhomat e fjetjes së të burgosurve, dhomat e punës, mjediset e veprimtarive profesionale e kulturore dhe ato të përbashkëta.
- **“Regjim i jashtëm”** është hapësira ndërmjet murit rrethues e rrethimit perimetrik, si dhe hapësira e sigurisë jashtë rrethimit perimetrik.

2.3 Burime të Kritereve

2.3.1 Kriteret e politikës

- Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë 2017–2020, miratuar me VKM nr. 773, datë 2.11.2016
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI).

2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Raportimet në kuadër të zbatimit të Konventës së OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave-CEDAW” 2016-2020;



- Raportet vjetore Publike të DPB (2016-2019);
- Analizat vjetore të DPB dhe IFVP-ve për vitet 2016-2019;
- Raportimet statistikore mujore të DPB;
- Raportimet në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, në lidhje me sistemin e burgjeve;
- Raporte të tjera monitorimi, studime dhe analiza të subjekteve nën auditim.

2.3.3 Kriteret teknike


- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligj nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 108/2018 “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998”;
- Ligj nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;
- Ligj nr.10 032, datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve”, i ndryshuar;
- Ligj nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- VKM nr. 437, datë 20.5.2015 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”;
- Udhëzim nr.103, datë 14.2.2014 “Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta personave të dënuar me burgim”;
- Urdhër i MD nr. 5251/2, datë 30/07/2010 Për miratimin e rregullores “Për rregullat e hollësishme të sjelljes së punonjësve të Policisë së Burgjeve”;
- Urdhër i MD nr. 5211, datë 07.06.2019 “Për pezullimin e përkohshëm të lejeve shpërblyese”;
- Rregulloret e Brendshme të institucioneve nën auditim.
- Marrëveshjet institucionale me objekt edukimin dhe trajnimet në vazhdimësi të të dënuarve dhe të paraburgosurve.

2.3.4 Kriteret e tjera/Praktikat më të mira

- 14 Rekomandimet e Këshillit të Evropës në lidhje me sistemin penitenciar: Rec(2006)2; CM/Rec(2012)5; CM/Rec(2008)11; Rec (2006) 13; Rec (2003) 23; Rec (2003) 20; Rec(2000) 20; CM/Rec(2014)3; Rec (99) 22; Rec (98) 7; Rec (93) 6; Rec (97) 12; Rec (99) 19; Rec (2012) 12.
- Modeli i Republikës së Kosovës : <https://shkk.rks-gov.net/home>



2.4 Piramida e pyetjeve audituese





KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
RAPORT “EFEKTIVITETI I SHËRBIMIT TË INSTITUCIONEVE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE”

Tabela 6 – Matrica e dizenjimit të auditimit

Nr.	Nënpetje të nivelit parë	Nënpetje të nivelit të dytë	Nënpetje të nivelit të tretë	Audituesi	Subjekt/e	Evidenca	Metodat e auditimit	Kalendari
1	1.1 A ofron sistemi i IEVP-ve kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore të përshtatshme për realizimin e objektivave institucionale dhe strategjike?	1.1.1 A kanë IEVP-të burime njerëzore të mjaftueshme për të realizuar shërbimet institucionale?	1.1.2 A zotërojnë IEVP-të infrastrukturë në përputhje me standardet?	K.Anastas	DPB, MD	- Strategjia Ndërsëktoriale e Drejtësisë 2017–2020, miratuar me VKM nr. 773, datë 2.11.2016; - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI) - Ligj nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar; - VKM nr. 437, datë 20.5.2015 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”;	<i>A-Grumbullim info.</i> - Shqyrtimi i dokumentacionit; - Intervista të hapura me personat përgjegjës; <i>B-Analizë info.</i> - Analizë cilësore; - Analizë sasore.	1.10.2020 - 15.11.2020
2	1.2 A ofrojnë IEVP-të programe efektive në përputhje me kuadrin rregullator dhe organizativ?	1.2.1 A janë efektive programet e punësimit në sistemin penitenciar?	1.2.2 A ofrojnë programet e edukimit siguri për riintegrimin në shoqëri të të dënuarve?	M.Berdo	DPB, MD	- Strategjia Ndërsëktoriale e Drejtësisë 2017–2020, miratuar me VKM nr. 773, datë 2.11.2016; - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI) - Ligj nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar; - VKM nr. 437, datë 20.5.2015 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”; - Raportimet në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, në lidhje me sistemin e burgjeve;	<i>A-Grumbullim info.</i> - Shqyrtimi i dokumentacionit; - Intervista të hapura me personat përgjegjës; - Pyetësorë; <i>B-Analizë info.</i> - Analizë cilësore; - Analizë sasore. <i>A-Grumbullim info.</i> - Shqyrtimi i dokumentacionit; - Intervista të hapura me personat përgjegjës; - Pyetësorë; <i>B-Analizë info.</i> - Analizë cilësore; - Analizë sasore.	1.10.2020 - 15.11.2020
				M.Berdo	DPB, MD	- Strategjia Ndërsëktoriale e Drejtësisë 2017–2020, miratuar me VKM nr. 773, datë 2.11.2016; - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI) - Ligj nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar; - Raportimet në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, në lidhje me sistemin e burgjeve;	<i>A-Grumbullim info.</i> - Shqyrtimi i dokumentacionit; - Intervista të hapura me personat përgjegjës; - Pyetësorë; <i>B-Analizë info.</i> - Analizë cilësore; - Analizë sasore.	1.10.2020 - 15.11.2020



2.5 Skema e Auditimit

2.5.1 Qasja/metodologjia e auditimit

Paradigma e këtij auditimi është: *“Trajtimi ligjor dinjitoz i kategorisë shoqërore me të drejta njerëzore të privuara të drejtuar, kah orinentimeve ndërkombëtare në harmoni me mirëqeverisjen e institucioneve penitenciare, është një instrument thelbësor për të ofruar qytetarë të rehabilituar për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike.”*

Në këtë auditim performance, grupi i auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjektet e përfshira dhe kuadrin ligjor e rregullator të fushës, gjykon si më të përshtatshme për arritjen e objektivave të auditimit qasjen pragmatike, pra një ndërthurje midis qasjes sasiore dhe asaj cilësore. Në funksion të kësaj qasjeje do të përdoren kritere të paravendosura në program, ku përfshihen baza ligjore e rregullative si dhe praktika të mira ndërkombëtare apo detyrimet e Konventave Ndërkombëtare dhe organizmave ndërkombëtar, grupi gjykon se aplikimi i kësaj qasjeje siguron një trajtim shterues të fokusit të auditimit.

Qasja cilësore do të përdoret kryesisht në analizimin e efektivitetit të kuadrit rregullator dhe strategjik që zbatojnë institucionet përgjegjëse në funksion të realizimit të përgjegjësiave. Qasja sasiore do të përdoret kryesisht në trajtimin e të dhënave financiare që IEVP-të subjekt auditimi administrojnë për të përmbushur objektivat si dhe vlerësimet financiare që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve akordon nëpërmjet programeve të investimeve. Brenda kësaj qasjeje grupi i auditimit do të trajton koston financiare të sistemit penenciar duke krahasuar efektivitetin e shërbimit të ofruar nga subjektet me të dhënat që do të përpunohen nga pyetësorët që do të hartohen nga grupi në këtë auditim.

2.5.2 Metodat/teknikat audituese

Metodat dhe teknikat audituese që do të përdoren në këtë auditim janë si vijon:

- Mbledhje, shqyrtim dhe analizim i dokumentacionit gjatë auditimit;
- Analiza dhe krahasimi i akteve strategjike dhe ligjore me situatën konkrete gjatë periudhës së auditimit dhe standardeve ndërkombëtare;
- Analizë sasiore dhe cilësore e informacionit të ofruar nga subjektet nën auditim;
- Rishikim dhe vlerësim i të dhënave dhe dokumentacionit të grumbulluar gjatë fazës studimore;
- Intervista me drejtuesit dhe specialistët e subjekteve nën auditim;
- Pyetësorë për personat që vuajnë veprat penale pranë IEVP-ve, për të kuptuar në çfarë mase ju shërbehet dhe cilësinë e ofrimit të tyre.

2.6 Rezultatet e parashikuara

2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë

Kontrolli i Lartë i Shtetit synon që nëpërmjet mesazhit auditues të paraqesë problematikat e sektorit të shërbimit ndaj kategorisë shoqërore të dënuar dhe të paraburgosur, si rrjedhojë e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse apo kuadrit rregullator të fushës. Rezultatet e këtij auditimi performance do të kenë impakt për Kuvendin, pasi do t'i krijojnë atij mundësinë për të njohur në mënyrë të detajuar me punën, pengesat dhe problematikat e organeve përgjegjëse për ekzekutimin e shërbimit të IEVP-ve, njëkohësisht duke vlerësuar rekomandimet në drejtim të përmirësimit të situatës.

Raporti përfundimtar, në të cilin pasqyrohen gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, ndihmon edhe ekzekutivin, në funksion të hartimit të politikave efektive, përmirësimit të kuadrit të nevojshëm rregullator për shërbimin e IEVP-ve, si dhe të forcimit e bashkërendimin të mtejshëm të veprimtarisë së institucioneve publike midis njëra-tjetrës në përmbushje thelbësore të standardeve referuar nga organizmat ndërkombëtare.



2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit

Ky auditim paraqet interes të lartë për publikun, pasi dinjiteti i trajtimit të kategorisë shoqërore të dënuar dhe të paraburgosur si dhe përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave në sistemin ndëshkimor, ka një vlerë të madhe sociale njëherësh edhe ekonomike me ndikim të drejtpërdrejtë në transparencën e ekzekutimit të shërbimit të IEVP-ve dhe llogaridhënien ndaj taksapaguesve apo organizmave ndërkombëtarë.

Duke audituar aktivitetin e institucioneve, pjesë e këtij auditimi, do të përpiqemi të bëjmë transparente veprimtarinë e tyre në administrimin dhe monitorimin e fondeve financiare dhe burimeve njerëzore. Nëpërmjet vlerësimit të efektivitetit dhe ekonomicitetit të këtij procesi, synojmë rritjen e përgjegjshmërisë së institucioneve dhe nëpunësve, përballë taksapaguesve dhe opinionit publik.

Për më tepër, duke evidentuar zhvillimet dhe problematikat që kanë shoqëruar këtë sektor në periudhën 2016 – 2019, synojmë përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit të veprimtarisë së IEVP-ve nëpërmjet rekomandimeve përkatëse.

2.6.3 Forma e publikimit

Në përfundim të auditimit përgatitet Projekt-Raporti i Auditimit, i cili do të diskutohet me të gjitha palët e përfshira. Pas diskutimeve me subjektet e audituara dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe vlerësimeve të tyre, përgatitet Raporti Përfundimtar i Auditimit, i cili do t'i përcillet subjekteve të përfshira në auditim dhe palëve të treta, si p.sh. Komisionet përkatëse në Kuvend. Një përmbledhje e Raportit Përfundimtar të Auditimit do të publikohet në faqen e internetit të KLSH-së dhe rrjetet sociale të Departamentit të Auditimit të Performancës (në Facebook dhe LinkedIn). Gjithashtu, raporti përfundimtar do të jetë pjesë e analizave dhe raportimeve periodike vjetore të veprimtarisë së KLSH-së. Në përfundim të auditimit, pas vendimit të Kryetarit të KLSH-së, do të përgatitet edhe një artikull për në median e shkruar.



3. SHTJELLIMI I PIRAMIDËS SË PYETJEVE TË AUDITIMIT

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, jemi përpjekur t’i japim përgjigje pyetjes kryesore:

A është efektiv shërbimi i IEVP-ve në Shqipëri për periudhën 2016-2019? dhe në përfundim u arrit në këtë mesazh auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, rritja e pozicioneve vakante në sistemin e burgjeve dhe rrjedhimisht rritja e ngarkesës së punës për punonjësit aktual ul eficiencën e shërbimit të këtij sistemi. Diferencimi në statusin e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe atij të Policisë së Burgjeve e ka bërë më pak të preferuar këtë të fundit. Kjo ka ndodhur si pasojë e kushteve të vështira në arsimim dhe kualifikim, shpërblim dhe logjistikë për Policinë e Burgjeve. Ndërsa, përdorimi i komandimit në detyrë në mënyrë të vazhdueshme nuk motivon drejtuesit e IEVP-ve, duke ndikuar edhe në eficiencën e punës.

Akti i fundit që rregullon shpërblimin e të dënuarve daton që në vitin 1993, shumë kohë përpara miratimit të vetë ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve. Kjo ka bërë që puna në IEVP të konsiderohet si një mjet për të përfituar uljen e ditëve nga dënimi dhe jo një mjet për të siguruar disa të ardhura. Heqja e lirisë është një dënim në vetvete dhe si rezultat, regjimi për të burgosurit nuk mund të përkeqësoj vuajtjen e burgimit me infrastruktura të amortizuara dhe ushqyerje jo të shëndetshme. Pavarësisht përpjekjeve të IEVP-ve për të realizuar trajnime në përmbushje të misionit të riintegrit të të dënuarve, shifrat e larta të recidivistëve shfaqin mungesë efektiviteti për formën e hartimit, zhvillimit dhe ndjekjes së trajnimeve edukuese.

3.1 A ofron sistemi i IEVP-ve kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore të përshtatshme për realizimin e objektivave institucionale dhe strategjike?

3.1.1 A kanë IEVP-të burime njerëzore të mjaftueshme për të realizuar shërbimet institucionale?

Organizimi i burimeve njerëzore në sistemin e burgjeve bëhet duke u bazuar në Urdhrin e KM nr. 49, datë 16.04.2015. Sipas të dhënave të DPB-së, numri total i stafit në sistemin e burgjeve është 4556 (shifra përfshin edhe 59 punonjës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve)¹¹. Shpërndarja e stafit është paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 7 – Shpërndarja e stafit në sistemin e burgjeve

	Në DPB	Në IEVP
Punonjës Policie	128	3431
Staf Civil	68	870
Punonjës në total	196	4301

Burimi: DPB

Përpunoi grupi i auditimit KLSH

Sipas të dhënave të DPB-së¹², në vitin 2019 në sistem ka pasur 279 vende vakante, nga të cilët 188 të tillë janë punonjës me uniformë dhe 91 janë staf civil. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre të fundit përbëhet nga mjekët dhe infermierët. Ekzistenca e vendeve vakante në sistem rezulton edhe nga numri i lartë i largimeve të punonjësve, pozicionet e të cilëve nuk mbulohen plotësisht nga rekrutimet e reja. Konkretisht, gjatë vitit 2019 janë kryer gjithsej 328 emëtime, ndërsa janë liruar

¹¹ Raport Publik i DPB-së 2019, fq.37

¹² Idem.



nga sistemi 397 punonjës¹³. Gjatë vitit 2018, janë kryer gjithsej 957 emëtime të reja, ndërsa janë liruar nga sistemi 524 punonjës¹⁴. Numri i lartë i emërimeve gjatë vitit 2018 lidhet edhe me inaugurimin e IEVP-së në Reç, Shkodër. Lëvizjet e stafit në sistemin e burgjeve janë detajuar në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8 – Lëvizjet e stafit në sistemin e burgjeve

	2018		2019	
	Emëtime	Lirime	Emëtime	Lirime
Punonjës Policie	736	398	204	263
Staf Civil	221	126	124	134
Punonjës në total	957	524	328	397

Burimi: DPB

Përpunoi grupi i auditimit KLSH

Në këtë auditim, grupi u fokusua në tre institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, përkatësisht IEVP Peqin, IEVP Vlorë dhe IEVP Rrogzhinë. Rritja e numrit të vendeve vakante gjatë viteve të fundit, veçanërisht në radhët e punonjësve të policisë, konstatohet edhe në tre IEVP-të në auditim. Të dhënat e mëposhtme tregojnë vendet vakante në IEVP Peqin gjatë periudhës 2016-2020 (muaji i marrë në shqyrtim është gushti i çdo viti).

Tabela 9 – Pozicionet vakante në IEVP Peqin

Gusht 2016	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	50	49	1
Punonjës Policie	311	310	1
Punonjës në total	361	359	2

Gusht 2017	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	50	49	1
Punonjës Policie	311	310	1
Punonjës në total	361	359	2

Gusht 2019	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	50	45	5
Punonjës Policie	311	295	16
Punonjës në total	361	340	21

Gusht 2020	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	50	46	4
Punonjës Policie	311	267	44
Punonjës në total	361	313	48

Burimi: IEVP Peqin

Përpunoi grupi i auditimit KLSH

¹³ Idem, fq.38

¹⁴ Analiza Vjetore e DPB 2018, fq.14



Siç shihet nga shifrat e mësipërme, numri i pozicioneve vakante në IEVP Peqin është rritur nga 2 në gusht 2017 në 48 në të njëjtin muaj të 2020. Gjithashtu vërehet se kurba e këtyre pozicioneve në radhët e stafit civil është e qëndrueshme, ndërsa numrin total e luhatin vendet e lira në radhët e punonjësve të policisë. Për sa i përket këtyre të fundit, numri i vendeve vakante është rritur nga 1 në gusht 2017 në 44 në të njëjtin muaj të 2020, ndërsa struktura ka mbetur e njëjtë.

Tabela 10 - Pozicionet vakante në IEVP Vlorë

Gusht 2016	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	34	34	0
Punonjës Policie	112	110	2
Punonjës në total	146	144	2

Gusht 2017	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	34	33	1
Punonjës Policie	112	110	2
Punonjës në total	146	143	3

Gusht 2018	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	34	34	0
Punonjës Policie	112	107	5
Punonjës në total	146	141	5

Gusht 2019	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	34	33	1
Punonjës Policie	112	112	0
Punonjës në total	146	145	1

Gusht 2020	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	34	31	3
Punonjës Policie	112	106	6
Punonjës në total	146	137	9

Burimi: IEVP Vlorë

Përpunoi grupi i auditimit KLSH

Të dhënat e mësipërme i përkasin IEVP-së Vlorë dhe tregojnë se mungesat në staf janë në numër të pranueshëm dhe kanë pasur luhatje të pakta përgjatë periudhës nën auditim.

Tabela 11 - Pozicionet vakante në IEVP Rrogozhinë

Gusht 2016	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	39	38	1
Punonjës Policie	147	145	2
Punonjës në total	186	183	3



Gusht 2017	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	39	37	2
Punonjës Policie	146	143	3
Punonjës në total	185	180	5

Gusht 2018	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	39	38	1
Punonjës Policie	145	144	1
Punonjës në total	184	182	2


Gusht 2019	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	39	38	1
Punonjës Policie	146	143	3
Punonjës në total	185	181	4

Gusht 2020	Nr. Punonjësve (sipas strukturës)	Nr. Punonjësve (Fakti)	Pozicione vakante
Staf Civil	39	33	6
Punonjës Policie	146	131	15
Punonjës në total	185	164	21

Burimi: IEVP Rrogozhinë, përpunoi grupi i auditimit KLSH

Në IEVP Rrogozhinë vërehet gjithashtu një rritje e theksuar e vendeve vakante gjatë vitit të fundit. Grafiku i mëposhtëm ilustron kurbën e vendeve vakante në IEVP-të nën auditim përgjatë periudhës 2016-2020:

Figura 4 – Grafiku i vendeve vakante në IEVP-të e audituara



Burimi: IEVP-të, përpunoi grupi i auditimit KLSH

Krahas mungesave në radhët e punonjësve të policisë në burgje, grupi i auditimit konstatoi edhe shqetësime në lidhje me stafin civil, veçanërisht mjekët. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion



nga DPB rezulton se aktualisht është plotësuar 73% e organikës së mjekëve në IEVP (32 mjekë nga 44 të parashikuar në strukturë). Për më tepër, nga vizitat e zhvilluara në terren, u konstatua se në disa raste, mjekët ishin punësuar me kohë të pjesshme dhe punonin me orar të kufizuar në IEVP. Megjithatë duhet theksuar se nga pyetësorët e zhvilluar nga grupi me të dënuarit në IEVP-të e audituara, këta të fundit ishin të kënaqur nga puna e stafit mjekësor dhe shprehnin rezerva për mungesën apo amortizimin e infrastrukturës.

Çështja e vendeve vakante u diskutua edhe në intervistat që grupi zhvilloi me stafin e IEVP-ve dhe DPB-së. Natyrisht që procedura e rekrutimit është e limituar në numrin e aplikimeve dhe plotësimin e kriterëve të vendosura nga DPB. Arsyeja përse prurjet në sistem nuk arrijnë të mbulojnë të gjitha daljet nga sistemi janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga motivet personale, mosplotësimi i kriterëve të vendosura, pagat dhe kushtet e punës, perceptimi se sistemi i burgjeve është një mjedis i vështirë, etj. Në këto raste bëhet e vështirë për të zëvendësuar të gjithë punonjësit që duan të largohen nga sistemi. Megjithatë, fokusi ynë është orientuar drejt arsyeve që kanë çuar në largimin e shumë punonjësve, veçanërisht atyre me uniforme.

Nga informacioni i mbledhur dhe intervistat e zhvilluara me punonjës të Policisë së Burgjeve rezultojnë disa probleme që mund të ndikojnë në situatën e lartpërmendur. Së pari, pozicionet vakante që krijohen në IEVP bëjnë që të rritet ngarkesa e punës për punonjësit aktualë, të cilëve iu duhet të punojnë orë shtesë për të mbuluar të gjithë shërbimin e kërkuar. Në disa raste, punonjësit e Policisë së Burgjeve nuk arrijnë as të gëzojnë të gjitha ditët e pushimit vjetor të paguara, të parashikuara nga ligji. Ky fenomen rrjedhimisht ul eficiencën e shërbimit të kësaj strukture, duke qenë se shërbimi duhet të mbulojë të gjitha orët e ditës, ndërkohë që burimet në dispozicion janë të kufizuara.

Më tej, një çështje tjetër e konstatuar nga grupi ishte statusi i policit të burgjeve në kontrast me atë të policit të shtetit. Rregullimi dhe organizimi i Policisë së Burgjeve tashmë bëhet nëpërmjet një akti të miratuar rishtazi, Ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”. Në nenin 4 të tij përcaktohet statusi i punonjësit të Policisë së Burgjeve dhe konkretisht neni 4/2 thekson se për çështjet që nuk rregullohen nga ligji në fjalë, gjejnë zbatim dispozitat e Kodit të Punës. Në ndryshim nga kjo dispozitë, Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” parashikon se punonjësi i policisë është nëpunës civil dhe ndaj tij zbatohen dispozitat e ligjit për nëpunësin civil, për aq kohë sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm¹⁵. Kjo tregon për diferencimin në statusin e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe atij të Policisë së Burgjeve, njëkohësisht duke e bërë më pak tërheqës këtë të fundit.

Ky diferencim vërehej edhe më tej në nivelin e pagës që përfitonin punonjësit e Policisë së Burgjeve. Gjatë periudhës së hartimit të këtij projekt-raporti auditimi, Këshilli i Ministrave miratoi VKM nr. 920, datë 25.11.2020 “Për trajtimin me pagë e shtesa mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të policisë së burgjeve”. Krahas rregullimit të kompensimeve të udhëtimit apo qerasë së banesës, miratimi i këtij akti ndryshoi nivelin e pagës bazë dhe shtesave mbi të që përfitojnë punonjësit e Policisë së Burgjeve, duke e përafruar me shpërblimin që marrin punonjësit e Policisë së Shtetit. Natyrisht që një veprim i tillë do të ndihmojë në përmirësimin e kushteve të punonjësve aktualë të policisë së burgjeve, por do ta bëjë edhe më të preferuar këtë institucion gjatë pranimit të prurjeve të reja.

Gjithashtu, vlen të përmendet çështja e kualifikimit të punonjësve të dy institucioneve të lartpërmendura. Për sa i përket Policisë së Shtetit, ajo ka institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të saj¹⁶. Akademia e Sigurisë¹⁷ është institucion i arsimit të lartë publik policor që synon specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit. Këta të fundit marrin arsim të lartë, madje edhe në nivel Master, ndërsa punonjësit e Policisë së Burgjeve nuk e përfitojnë këtë arsimim nëpërmjet Akademisë apo

¹⁵ Neni 39 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”

¹⁶ Neni 37 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”

¹⁷ VKM nr. 185, datë 25.02.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”



një institucioni të ngjashëm. Pranimi në Policinë e Burgjeve bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur kombëtar, i cili përfshin një testim me shkrim, një testim me gojë, testim psikologjik, si dhe vlerësimin e aftësive fizike e profesionale të kandidatit¹⁸. Kështu, tek sa kriteret për pranim në të dyja këto institucione janë të ngjashme, kualifikimi dhe trajnimi që përfitojnë punonjësit e Policisë së Shtetit është i një niveli shumë më të lartë se sa ata të Policisë së Burgjeve (të rekrutuarit e Policisë së Shtetit kryejnë arsim të lartë). Kështu, krahas mbështetjes financiare të ofruar nga shteti, përmirësimi i aspektit arsimor, trajnues dhe trajtimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve është shumë i rëndësishëm për rritjen e efektivitetit të shërbimit në IEVP. Cilësia e shërbimit rritet në raport të drejtë me rritjen e kualifikimit të punonjësve dhe njëkohësisht stimulon më shumë persona për të aplikuar në vendet që shpall Policia e Burgjeve.

Një tjetër konstatim i këtij auditimi kishte të bënte me statusin e drejtuesve të IEVP-ve. Në sistemin e burgjeve bën përshtypje dukuria e komandimit të drejtorëve të këtyre institucioneve. Konkretisht, në të tre IEVP-të e përzgjedhura nga grupi në këtë auditim, përkatësisht Peqini, Vlora dhe Rrogozhina, ishin vendosur drejtorë të komanduar. Sigurisht që punonjësit e sistemit mund të komandohen për mbarëvajtjen ose për përballimin e mbingarkesës apo një situata emergjente. Megjithatë, ky fenomen nuk është parashikuar për të qenë afatgjatë, por vetëm për një periudhë të caktuar kohe. Nga informacionet e marra nga DPB rezulton se një pjesë e konsiderueshme e IEVP-ve funksionojnë me drejtues të komanduar dhe jo të emëruar. Madje, në disa IEVP është kthyer në praktikë ndryshimi i një Drejtori të komanduar me një tjetër me të njëjtin status.

Pavarësisht seriozitetit në kryerjen e detyrës nga ana e drejtorëve të komanduar, duhet mbajtur parasysh se komandimi është parashikuar të jetë një mjet i përkohshëm për të zgjidhur ngërçe në situata të veçanta. Përdorimi i tij në mënyrë të vazhdueshme nuk motivon drejtuesit, të cilët ndihen me statusin e të përkohshmit në një pozicion të caktuar, duke ndikuar edhe në eficiencën e punës.

Gjetje

1. Rritja e numrit të vendeve vakante në sistem gjatë viteve të fundit, veçanërisht në radhët e punonjësve të policisë së burgjeve, konstatohet edhe në tre IEVP-të në auditim. P.sh. numri i pozicioneve vakante në IEVP Peqin është rritur nga 2 në gusht 2017 në 48 në të njëjtin muaj të 2020. Në IEVP Rrogozhinë vërehet gjithashtu një rritje e theksuar e vendeve vakante gjatë vitit të fundit.
2. Krahas mungesave në radhët e punonjësve të policisë në burgje, grupi i auditimit konstatoi edhe shqetësime në lidhje me stafin civil, veçanërisht mjekët. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion rezulton se aktualisht është plotësuar 73% e organikës së mjekëve në IEVP. Nga vizitat e zhvilluara në terren, u konstatua se në disa raste, mjekët ishin punësuar me kohë të pjesshme dhe punonin me orar të kufizuar në IEVP.
3. Pozicionet vakante që krijohen në IEVP bëjnë që të rritet ngarkesa e punës për punonjësit aktualë të Policisë së Burgjeve, të cilëve iu duhet të punojnë orë shtesë për të mbuluar edhe shërbimin.
4. Një çështje tjetër e konstatuar nga grupi ishte statusi i policit të burgjeve në kontrast me atë të policit të shtetit, ku këta të fundit përfitojnë statusin e nëpunësit civil ndërsa policët e burgjeve jo.
5. Kriteret për pranim në të dyja këto institucione janë të ngjashme, ndërsa kualifikimi dhe trajnimi që përfitojnë punonjësit e Policisë së Shtetit është i një niveli shumë më të lartë se sa ata të Policisë së Burgjeve.
6. Një pjesë e konsiderueshme e IEVP-ve funksionojnë me drejtues të komanduar dhe jo të emëruar. Madje, në disa IEVP është kthyer në praktikë ndryshimi i një Drejtori të komanduar me një tjetër me të njëjtin status.

¹⁸ Neni 29/3 i Ligjit nr. 80/2020 "Për Policinë e Burgjeve"



Konkluzione

- Rritja e pozicioneve vakante në sistemin e burgjeve dhe rrjedhimisht rritja e ngarkesës së punës për punonjësit aktual ul eficiencën e shërbimit të këtij sistemi, duke qenë se shërbimi duhet të mbulojë të gjitha orët e ditës, ndërkohë që burimet në dispozicion janë të kufizuara. Konkretisht, kjo përkthehet në ulje të cilësisë së shërbimit.
- Mos përfitimi i statusit të nëpunësit civil nga punonjësit e Policisë së Burgjeve e ka bërë më pak tërheqës këtë të fundit në drejtim të aplikimeve për vende pune nga individët.
- Krahas mbështetjes financiare të ofruar nga shteti, përmirësimi i aspektit arsimor, trajnues dhe trajtimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve është shumë i rëndësishëm për rritjen e efektivitetit të shërbimit në IEVP. Cilësia e shërbimit rritet në raport të drejtë me rritjen e kualifikimit të punonjësve dhe njëkohësisht nxit rritjen e kërkesës për aplikim në Policinë e Burgjeve.
- Komandimi është parashikuar të jetë një mjet i përkohshëm për të zgjidhur ngërçe në situata të veçanta. Përdorimi i tij në mënyrë të vazhdueshme nuk motivon drejtuesit, të cilët ndihen me statusin e ‘të përkohshmit’ në një pozicion të caktuar, duke ndikuar edhe në eficiencën e punës.

Rekomandime

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masat e nevojshme për të mbuluar mungesat e krijuara nga pozicionet vakante në stafin e IEVP-ve, nëpërmjet rekrutimit të burimeve të reja apo rialokimit të atyre ekzistuese.

Deri në Qershor 2021

Në lidhje me këtë rekomandim, *Ministria e Drejtësisë është shprehur se procedura e rekrutimit është zhvilluar një deri në dy herë në vit, kur krijohet një numër i konsiderueshëm vendesh të lira. Njëra nga arsytet është që shpalljet për rekrutim nuk mund të bëhen për një numër të ulët të vendeve vakante. Arsye tjetër është dinamika që ka Policia e Burgjeve, si dalje në pension, lirime me kërkesë, por edhe largime me procedurë disiplinore. Me datë 7.12.2020 deri më 18.12.2020, janë zhvilluar procedurat e konkurimit për pranim në Policinë e Burgjeve dhe janë përzgjedhur 139 kandidatë, të cilët do të trajnohen gjatë muajit janar dhe shkurt dhe më pas do të emërohen në sistemin e burgjeve. Shpjegimi i subjektit na njeh me masat pozitive të marra në këtë kuadër, megjithatë grupi vlerëson se ai nuk kundërshton rekomandimin. Efekti i masave të mësipërme mund të vlerësohet nga një auditim vijues për zbatimin e rekomandimeve.*

2. Ministria e Drejtësisë, me asistencën e Drejtorisë së Burgjeve apo në bashkëpunim me institucione të tjera, të shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të procesit të pranimi në Policinë e Burgjeve, në linjë me procesin e aplikuar nga Policia e Shtetit (nëpërmjet një institucioni si Akademia e Sigurisë), me qëllim të mëtejshëm ndryshimin e statusit dhe nivelit të kualifikimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve në linjë me ata të Policisë së Shtetit.

Deri në Qershor 2021

Në lidhje me këtë rekomandim, *Ministria e Drejtësisë thekson se ka lidhur marrëveshje me Ministrinë e Brendshme me nr. 3253 Prot datë 19.03.2018, me objekt forcimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë së burgjeve, zhvillimin deri në 4 procese testimi në vit, për pranimin e kandidatëve të rinj, etj dhe mbi këtë bazë, të gjitha proceset e testimit për rekrutim, për ngritje në gradë dhe të trajnimit të punonjësve të rinj, i ka zhvilluar në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, nga fillimi i vitit 2018 e në vijim, por ky bashkëpunim është kufizuar gjatë këtij viti për shkak të pandemisë.*

Në lidhje me këtë, grupi gjykon se komenti nuk kundërshton rekomandimin. Marrëveshja e



bashkëpunimit është një hap i hedhur në drejtim të realizimit të tij, por qëllimi përfundimtar është të arrihet njehësimi i plotë i Policisë së Shetit me atë të Burgjeve, në arsimim, kualifikim dhe në status.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të propozojë pranë Ministrisë së Drejtësisë emrat për drejtues të IEVP-ve, me qëllim emërimin e tyre, duke e ruajtur komandimin si një mjet të përkohshëm për situata të caktuara.

Deri në Qershor 2021 dhe në vazhdimësi

3.1.2 A zotërojnë IEVP-të infrastrukturë në përputhje me standardet?

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë objekte, dimensiononi i së cilave shtrihet përtej konturimit fizik të tyre. Për nga përbërja e veçantë të personave që popullojnë ato, shtetet ndërmarrin angazhime, për të ndërtuar apo rikonstruktuar këto mjedise të tilla që të jenë sa më të përshtatshme për zhvillimin e jetës normale të individëve që vuajnë aty dënimin. Nisur nga theksi që institucionet ndërkombëtare i mëshojnë cilësisë infrastrukturore të IEVP-ve, si një parakusht për të respektuar trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, grupi i auditimit e gjykoj të arsyeshme të vlerësoj kushtet infrastrukturore që subjektet e auditimit ofrojnë. Për të konkretizuar opinionin auditues grupi i auditimit shqyrtoj:

4. Nivelin e popullimit të ambienteve të brendshme të IEVP-ve;
5. Kushtet e brendshme të dhomave të qëndrimit;
6. Kushtet hijeno-sanitare të IEVP-ve;
7. Hapësirat e përbashkëta të ajrit, aktiviteteve trajnuese, edukuese dhe kreative;
8. Ambientet e mbajtjes dhe shërbimit të ushqimit, ambientet e takimeve, etj.


Për subjektet e këtij auditimi, duke qenë se përgjatë trajtimit të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve, grupi i auditimit i referohet të paraburgosurve dhe të dënuarve së bashku për të përshkruar çështjet objekt auditimi, ndihet e nevojës për të shpjeguar këto terma. Nisur nga vetë kriteri ligjor¹⁹ si bazë krahasuese për të vlerësuar masën dhe cilësinë e trajtimit të individëve që popullojnë sistemin penitenciar, përfitimi i të drejtave nuk ka diferencim mes të dënuarve (*me vendim gjykate të formës së prerë*) dhe të paraburgosurve (*me masën arrest me burg*). Të dy këto kategori akomodohen në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe përfitojnë pa dallim dhe pa njëanësi midis tyre shërbimet nga këto subjekte publike, trajtimin sipas ligjit²⁰ si dhe në respektim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Si e tillë edhe grupi i auditimit të KLSH, kur vlerëson efektivitetin e shërbimeve të IEVP-ve, nuk i trajton si kategori të veçuara midis njëra tjetrës, në harmoni kjo me aktet ligjore në fuqi.

Përgjatë periudhës objekt auditimi 2016-2019, IEVP-të kanë njohur luhatje në numrin mesatar të paraburgosurve dhe të dënuarve që janë trajtuar në ditë krahasuar kjo me kapacitetet e tyre. Grafikisht si më poshtë:

¹⁹ Ligj Nr.8328, datë 16.4.1998 Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve, i ndryshuar

²⁰ Ibid.

Figura 5 – Grafiku i popullimit të IEVP-së Peqin, Vlorë, Rrogozhinë



Burimi: IEVP Peqin, Rrogozhinë, Vlorë
Përpunoi grupi i auditimit KLSH

Gjetje

1. Në zbatim të Urdhrit nr.8927/1 datë 27.09.2018, i ndryshuar, i cili klasifikon IEVP-të sipas sistemeve të sigurisë, si dhe kundrejt kapaciteteve për secilën IEVP që grupi i auditimit ka siguruar nga DPB, rezulton se: për vitin 2016, 2017 dhe 2018, IEVP Peqin dhe IEVP Rrogozhinë kanë funksionuar përtej kapaciteteve akomoduese për të dënuarit.

Konkretisht tabela më poshtë jep informacion mbi numrin e të paraburgosurve dhe të dënuarve sipas subjekteve të auditimit respektivisht për secilin vit si dhe kapacitet e tyre për të bërë krahasimin:

Tabela 12 – Kapacitetet për të dënuarit

Viti	Vlorë	Peqin	Rrogozhinë
2016	165	638	383
2017	142	596	377
2018	125	609	365
2019	139	506	317
Kapaciteti	160	558	343

Burimi: IEVP Peqin, Rrogozhinë, Vlorë, përpunoi grupi i auditimit KLSH

Prej evidencave të siguruar gjatë fazës së terrenit, në këto subjekte objekt auditimi konstatohet reduktim i numrit të të dënuarve për numër kapaciteti, i përkthyer si reduktim i fenomenit të mbipopullimit të burgjeve. Si e tillë edhe shpërndarja infrastrukture të numrit të dhomave dhe numrit të popullimit, rezulton se respekton normativat e cituara në nenin 30 të Vendimi nr. 437, datë 20.5.2015 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”, të cilat janë 4m² për

person. Gjatë vëzhgimeve të ambienteve të brendshme nga grupi i auditimit si dhe evidencat e dërguara, rezulton se: subjektet në auditim ofrojnë ambiente shërbimi për të dënuarit si; ambiente të ushtrimit të ritualeve fetare, ambiente të shërbimeve shëndetësore, ambientet e punonjësve social, ambiente trajnimi, dhomat e takimeve dhe atyre të prindërimit si dhe biblioteka, lavanteri dhe kuzhinë.

Gjetje

2. Krahاسimi i kushteve të këtyre hapësirave midis subjekteve në auditim si dhe me standardet evropiane²¹, ka dallime të ndjeshme në të cilat rezulton se: në IEVP Rrogozhinë ofrohen standarde tepër të ulta të kompletimit të dhomave të fjetjes. Strehimi nuk respekton dinjitetin njerëzor, në veçanti kushteve higjienike, kushteve të ngrohjes dhe ajrimit.

Për të bazuar opinionin auditues si evidencë mbështetëse, grupi i auditimit ka zhvilluar gjatë fazës së terrenit intervista me përfituesit e shërbimit të IEVP-ve, konkretisht me të paraburgosur dhe të dënuar, përzgjedhja e të cilëve është bërë në mënyrë rastësore nga stafi i IEVP-ve.

Gjetje

3. Nga intervistat me të paraburgosur dhe të dënuar në IEVP Rrogozhinë rezulton se : ambientet e dhomave të fjetjes, sallave të aktivitetit fizik, lavanterisë dhe tualeteve janë kompletuar prej familjarëve të tyre në vazhdimësi. Gjatë vëzhgimit në terren nga grupi i auditimit, u vu re që ambientet e brendshme të kuzhinës dhe ato të ruajtjes së ushqimit siguroheshin në kushte të ulta infrastrukturore dhe hijeno-sanitare.

Në respektim të ndalimit të aparateve fotografik brenda shërbimit të brendshëm, grupi i auditimit ka fotografuar vetëm ambientet e ruajtjes së ushqimeve si më poshtë.



Amortizim dhe lagështi - IEVP Rrogozhinë - Infrastruktura e ruajtjes së fruta perimeve



Produkt begtoral

- IEVP Rrogozhinë -

Mbeturina ku punon i dënuari

²¹ Rekomandim (2006) 2 mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve



Për të dhënë një panoramë më e qartë të gjendjes infrastrukturore të IEVP Rrogozhinë, grupi i auditimit ka siguruar informacion nga Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, për zërin e investimeve në buxhet.

Gjetje

4. Nga informacioni i evidencave mbi prokurimet publike siguruar nga subjekti rezulton se: nuk ka asnjë vlerësim financiar në regjistrat e parashikimit dhe në regjistrat e realizimit të prokurimeve publike, për zërin e investimeve në IEVP Rrogozhinë.
5. Në lidhje me ushqimin e siguruar në IEVP-të subjekt auditimi, normat e miratuara²² të ushqimit ditor për të dënuarit i klasifikojnë vlerat energjike të ushqimit sipas të dënuarve të punësuar dhe të mitur, të pa punësuar dhe të dënuar me probleme shëndetësore, konkretisht në 3033k/kal; 2615 k/kal; dhe 3345k/kal. Në këto subjekte mungonte uji i pijshëm për të dënuarit.

Konkluzione

- Mungesa e theksuar e investimeve infrastrukturore për periudhën objekt auditimi, e cila ofron mosrespektim të kushteve minimale të fjetjes, ushqimit, pushimit dhe atyre higjieno sanitare në IEVP Rrogozhinë, jo vetëm që nuk përmbush detyrimet e legjislacionit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare, por njëherësh ul dinjitetin e të dënuarve që ushtrojnë ekzekutimin e veprës penalë në këtë burg, duke ofruar shërbime që cenojnë efektivitetin institucional.
- Mungesa e sigurimit të dietës ushqimore e cila nuk merr parasysh moshën e të dënuarve, shëndetin, kushtet fizike, fenë, kulturën dhe natyrën e punës që kryejnë, si dhe mos përditësimi i saj që prej viti 2006, ofron thjesht ofrimin e tre vakteve ushqimore për të dënuarit, por jo ushqyerjen e shëndetshme të tyre. Mungesa e ujit të pijshëm në IEVP për të dënuarit, cenon të drejtën themelore të tyre, duke provokuar njëherësh shpenzime monetare në njësinë tregtare.

Rekomandime

1. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Rrogozhinë të hartojnë planin e masave për respektimin e kushteve infrastrukturore sipas standardeve të legjislacionit në fuqi dhe në harmoni me ato ndërkombëtare.

Brenda muajit Mars 2021

2. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të rishikojnë normën ushqimore të të dënuarve ku të parashikojnë moshën e të dënuarve, shëndetin, kushtet fizike, fenë, kulturën dhe natyrën e punës që kryejnë si dhe në respektim të rekomandimeve të Këshillit të Evropës mbi rregullat e burgjeve.

Brenda 6-mujorit të parë të 2021

3. Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Peqin, Rrogozhinë dhe Vlorë të sigurojnë ujin e pijshëm për të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Brenda 6-mujorit të parë të 2021

Në funksion të shqyrtimit të kapaciteteve infrastrukturore të IEVP-ve, grupi i auditimit i kushtoj vëmendje të veçantë hapësirave ku ushtrohen aktivitetet e përbashkëta si bokset e ajrimit, sallat e edukimit, ambientet e realizimit të takimeve, bibliotekat dhe fushat sportive. Kjo për vetë faktin se

²² Urdhër i përbashkët midis MD dhe MSH datë 27.07.2006 “Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit



një pjesë e mirë e veprimtarisë së të burgosurve ofrohet jashtë qelive me qëllim përshtatjen dhe ndërveprimin njerëzor dhe shoqëror ashtu sikurse dhe çlodhjen apo përmirësimin e kushteve fizike

Gjetje

6. Gjatë fazës së terrenit grupi i auditimit konstaton se: hapësirat bibliotekare nuk ofrojnë literaturë bazë për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, legjislacionin bazë penal, procedural penal²³. Mungon përmbajtja e titujve shkencor dhe artistik si dhe përditësimi i tyre.
7. Gjatë zhvillimit të intervistave me përfituesit e shërbimit të IEVP-ve, konkretisht me të paraburgosur dhe të dënuar të IEVP Rrogozhinë, rezultoi se : hapësirat e zhvillimit të aktiviteteve sportive janë të kufizuara dhe në terren të papërshtatshëm për shëndetin dhe në IEVP-të Vlorë dhe Peqin, mungojnë mjetet didaktike për zhvillimin e aktiviteteve fizike.

Konkluzione

- Vetëm ekzistenca fizike e ambienteve të ndërveprimit social, pa plotësuar kushtet didaktike të vendosjes së tyre në funksion të të dënuarve, nuk sjellë përmbushje të detyrimit institucional të IEVP-ve. Efektiviteti i realizimit të shërbimit të burgjeve vlerësohet në harmoni me balancimin e plotësimit jo vetëm të utilitetit fjetje dhe ushqim, por edhe në konsideratën financiare që i atribuohet sallave të lojërave, ambienteve familjare të dhomave të prindërimit, dhomave të kompletuara të kujdesit shëndetësor brenda burgjeve si edhe bibliotekave të pasura.

Rekomandime

4. IEVP-të Peqin, IEVP Rrogozhinë dhe IEVP Vlorë të marrin masa për të kompletuar bibliotekat me literaturë bazë për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, legjislacionin bazë penal, procedural penal²⁴ si dhe të pasurojnë përmbajtjen e titujve shkencor dhe artistik.

Brenda 6-mujorit të parë të 2021

5. IEVP-të Peqin, IEVP Rrogozhinë dhe IEVP Vlorë të marrin masa për të kompletuar ambientet e përbashkëta, ambientet sportive dhe dhomat e prindërimit, me pajisjet didaktike për vendosjen në funksion të tyre si dhe mjetet e nevojshme të komunikimit më zyrtar korrespondente të avokatit të popullit, të tillë që të përafrojnë jetën në burg sa më shumë që të jetë e mundur me aspektet pozitive të jetës në komunitet.

Brenda 6-mujorit të parë të 2021

3.2 A ofrojnë IEVP-të programe efektive në përputhje me kuadrin rregullator dhe organizativ?

3.2.1 A janë efektive programet e punësimit në sistemin penitenciar?

Gjatë qëndrimit apo vuajtjes së dënimit në IEVP, të dënuarve dhe të paraburgosurve iu njihet e drejta për të punuar. Kjo punë nuk ka karakter dënimi dhe duhet të shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara. Punësimi i të dënuarve dhe paraburgosurve rregullohet në nenet 34-36 të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve²⁵.

Të dhënat më poshtë, të vëna në dispozicion nga MD, ilustrojnë numrin e të dënuarve të punësuar në IEVP gjatë periudhës së auditimit:

²³ Vendimi nr. 437, datë 20.5.2015 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”, neni 59

²⁴ Vendimi nr. 437, datë 20.5.2015 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”, neni 59

²⁵ Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, i ndryshuar “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”

Tabela 13 – Numri i të burgosurve të punësuar në IEVP sipas viteve

	Nr. i të burgosurve të punësuar në IEVP	Nr. i personave të rritur në IEVP (të dënuar dhe të paraburgosur)
Qershor 2016	610	5713
Qershor 2017	613	5419
Qershor 2018	654	5371
Qershor 2019	646	5156
Qershor 2020	540	4475

Burimi: MD/DPB, përpunoi grupi i auditimit KLSH

Siç dallohet nga tabela e mësipërme, numri i personave të punësuar në burgje përbën rreth 12% të numrit total të personave të rritur që qëndrojnë në IEVP-të e vendit. Më tej, paraqitet organika e të punësuarve në një nga IEVP-të në auditim, më konkretisht ai i Rrogozhinës, për të dalluar llojet e punëve që kryejnë të dënuarit:

Pozicioni i punës	Nr. i punonjësve (35)
Sanitar	8
Kulti	2
Ndihmës Kuzhinier	5
Punonjës biblioteke	2
Berber	1
Punonjës lavanderie	1
Magazininier	2
Lulishtar	3
Bojaxhi	1
Instruktur palestere	3
Shpërndarje ushqimi	7

Burimi: IEVP Rrogozhinë, përpunoi grupi i auditimit KLSH

Nga këto të dhëna rezulton se pozicionet e punës që ofrohen në IEVP për të dënuarit janë kryesisht të tipit të shërbimeve brenda ambienteve të burgut. Në asnjë nga IEVP-të e audituara nuk ka të dënuar të punësuar jashtë ambienteve të institucionit, p.sh. nga një subjekt privat që kërkon forcë pune. Kjo praktikë nuk është e përdorur në sistemin shqiptar të burgjeve, por në disa vende të tjera të Evropës perëndimore është e përhapur gjerësisht. Ajo mund të ndihmojë të dënuarit profesionalisht dhe për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri. Për më tepër, puna në subjekte të tjera mund t'i ndihmojë ata për të siguruar të ardhura për veten apo familjen. Njëkohësisht ekziston edhe baza ligjore për të realizuar diçka të tillë, pasi puna jashtë institucionit parashikohet në nenin 36 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, i ndryshuar²⁶. Për më tepër, një mundësi e tillë parashikohet në pikën 26.9 të Rregullave Evropiane të Burgjeve²⁷, ku theksohet shprehimisht: “Puna për të burgosurit jepet nga autoritetet e burgut, ose në bashkëpunim me kontraktorë privatë, brenda ose jashtë burgut.”

²⁶ “Kur në institucion nuk është e mundur të sigurohet puna për të paraburgosurit dhe të dënuarit, tërësisht ose pjesërisht, mund të sigurohen fronte pune jashtë institucionit, duke aktivizuar të paraburgosurit dhe të dënuarit me kriterin e aftësisë për punë, formimin profesional dhe duke preferuar të paraburgosurit dhe të dënuarit që kanë pasur më pak aktivizim pune. Në çdo rast, dalja jashtë institucionit dhe kryerja e punës bëhen gjithmonë të shoqëruar nga personeli i institucionit dhe të ruajtur nga policia e burgjeve.”

²⁷ Rekomandim (2006)2 i Këshillit të Ministrave mbi Shtetet Anëtare (Këshilli i Evropës), pika 26.9



Punësimi i të dënuarve në burgje dhe paraburgime bëhet nga administrata e IEVP-ve sipas procedurës së përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 2259, datë 11.03.2008. Ndryshimet e ndodhura në sistem gjatë këtyre 12 viteve kanë bërë që disa pika të urdhrin të mos jenë të përditësuara me situatën aktuale. Konkretisht, ky akt përcakton se kryetar i komisionit që merret me përcaktimin e punësimit të të dënuarve do të jetë zv/drejtori i IEVP-së përkatëse. Sipas organikës aktuale rezulton se ky pozicion nuk figuron më në IEVP-të e vendit, duke bërë që cilësinë e kryetarit të komisionit ta marrin punonjës të tjerë të administratës së institucionit sipas rastit. P.sh. në një nga praktikat e shqyrtuara nga grupi, këtë atribut e kishte marrë përgjegjësi i sektorit ligjor. Në fund të çdo muaji, llogaritja e ditëve të punës për secilin të dënuar të punësuar bëhet nga administrata e IEVP-së. Puna e zhvilluar rregullisht brenda muajit llogaritet në mënyrë standarde 26 ditë, duke përfshirë ditët e diela në linjë me nenin 85/2 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, nga vizitat e grupit në ambientet e IEVP-ve dhe diskutimet me stafin u vu re se nuk kishte ndonjë sistem për mbikëqyrjen e të punësuarve, për të verifikuar kryerjen faktike të punës. Të vetmit persona që mund ta bënë këtë gjë janë punonjësit e policisë brenda regjimit të burgut dhe vetë të dënuarit. Nëse do të marrim në konsideratë listën e mësipërme të pozicioneve të punës, vërejmë se ka detyra të cilat zhvillohen gjatë gjithë javës, përfshirë edhe ditën e dielë (p.sh. shpërndarësi i ushqimit e ushtron detyrën çdo ditë të javës). Kjo bën që kryerja faktike e punës nga ana e të dënuarit të jetë e vështirë për t'u monitoruar. Rrjedhimisht, përcaktimi i ditëve të tij të punës gjatë muajit bëhet në mënyrë të përafërt.

Një tjetër problem i konstatuar gjatë auditimit është edhe çështja e shpërblimit të të dënuarve të punësuar. Sipas Ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, i ndryshuar “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, puna shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. VKM-ja e fundit që rregullon këtë çështje daton që në vitin 1993²⁸, shumë kohë përpara miratimit të vetë ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve. Sipas këtij akti, shpërblimi mujor për të dënuarit e punësuar është 90 lekë. Duke mbajtur parasysh të gjitha ndryshimet e vlerës së monedhës shqiptare gjatë këtyre 3 dekadave, ky shpërblim mujor mund të konsiderohet i papërfillshëm. Kjo gjë cenon respektimin e pikës 26.10 të Rregullave Evropiane të Burgjeve²⁹, e cila thekson shprehimisht “Në të gjitha rastet, puna e të burgosurve shpërblehet me pagesën e duhur”. Në IEVP-të e audituara rezulton që shpërblimi mujor për punën nuk paguhet në favor të të dënuarve të punësuar prej 6 vitesh, sipas rekomandimeve të auditimit të brendshëm në MD. Aktualisht, e vetmja gjë që përfitojnë të dënuarit nga puna e kryer është një ulje dënimi prej 3,9 ditësh në muaj sipas Dekretit nr.7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”. Mungesa e shpërblimit për punën e të dënuarve lidhet edhe me probleme të tjera. Kështu, atyre nuk u paguhen sigurimet shoqërore dhe rrjedhimisht puna e kryer nuk u njihet si vjetërsi për efekt pensioni. Kjo bie në kundërshtim me nenin 35 të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve “Puna është me shpërblim dhe përfshihet në vjetërsinë në punë për efekt pensioni.”, si dhe me pikën 26.17 të Rregullave Evropiane të burgjeve “Të burgosurit të cilët punojnë, për aq sa të jetë e mundur, përfshihen në sistemet e sigurimeve shoqërore”.

Gjetje

1. Në asnjë nga IEVP-të e audituara nuk ka të dënuar të punësuar jashtë ambienteve të institucionit, p.sh. nga një subjekt privat që kërkon forcë pune.
2. Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 2259, datë 11.03.2008 përcakton se kryetar i komisionit që merret me përcaktimin e punësimit të të dënuarve do të jetë zv/drejtori i IEVP-së përkatëse, por sipas organikës aktuale rezulton se ky pozicion nuk figuron më në IEVP-të e vendit.

²⁸ VKM nr.228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”

²⁹ Rekomandim (2006)2 i Këshillit të Ministrave mbi Shtetet Anëtare (Këshilli i Evropës), pika 26.10



3. Nga vizitat e grupit në ambientet e IEVP-ve dhe diskutimet me stafin u vu re se nuk kishte ndonjë sistem për mbikëqyrjen e të punësuarve, për të verifikuar kryerjen faktike të punës
4. VKM-ja e fundit që rregullon shpërblimin e të dënuarve daton që në vitin 1993, shumë kohë përpara miratimit të vetë ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve.
5. Mungesa e shpërblimit për punën e të dënuarve lidhet edhe me probleme të tjera. Kështu, atyre nuk u paguhen sigurimet shoqërore dhe rrjedhimisht puna e kryer nuk u njehet si vjetërsi për efekt pensioni.

Konkluzione

- Punësimi në subjekte të tjera jashtë ambienteve të institucionit mund të ndihmojë të dënuarit profesionalisht, për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri dhe për më tepër, mund t'i ndihmojë ata për të siguruar të ardhura për veten apo familjen.
- Duke mbajtur parasysh të gjitha ndryshimet e vlerës së monedhës shqiptare gjatë këtyre 3 dekadave, shpërblimi mujor për të dënuarit e punësuar mund të konsiderohet i papërfillshëm.
- Pagesa jo e duhur, mos njohja e vjetërsisë së punës dhe mos pagimi i sigurimeve shoqërore përbën shkelje të Ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, i ndryshuar “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe Rregullave Evropiane të Burgjeve.

Rekomandime

1. Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, së bashku me IEVP-të përkatëse të nxisin punësimin e të dënuarve në subjekte të tjera jashtë institucionit ku vuajnë dënimin, nëpërmjet fushatave promovuese, marrëveshjeve të bashkëpunimit, etj.

Deri në Qershor 2021 dhe në vazhdimësi

2. Ministria e Drejtësisë të bëjë përditësimin e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 2259, datë 11.03.2008, duke reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur ndër vite në sistemin e burgjeve.

Deri në Qershor 2021

3. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, së bashku me IEVP-të përkatëse të ngrenë një sistem më eficient për monitorimin e punës faktike të të dënuarve dhe llogaritjen përkatëse të ditëve të punës.

Deri në Qershor 2021 dhe në vazhdimësi

4. Ministria e Drejtësisë të propozojë pranë Këshillit të Ministrave ndryshimin e VKM nr.228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”, në mënyrë që të sigurohet një pagesë e duhur për të dënuarit e punësuar.

Deri në Qershor 2021

Në lidhje me rekomandimet e mësipërme, MD shprehet se është në proces VKM-ja për punësimin e të burgosurve, e cila do të miratohet në kuadër të hartimit të të gjitha akteve nënligjore që do të dalin në zbatim të Ligjit Nr.81/2020 “Për të drejta dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” të cilat do të rregullojnë aspekte të tilla si punësimi, arsimimi dhe ushqimi i të burgosurve.

Grupi vlerëson se komentit nuk kundërshton rekomandimet, por paraqet masat që janë marrë dhe do të merren për zbatimin e tyre. Efekti i masave të mësipërme mund të vlerësohet nga një auditim vijues për zbatimin e rekomandimeve.



3.2.2 A ofrojnë programet e edukimit siguri për riintegrimin në shoqëri të të dënuarve?

Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetje auditimi, grupi i auditimit gjykoi si të rëndësishme për të shqyrtuar çështje që lidhen me:

- Metodologjinë e identifikimit të programeve të edukimit;
- Realizimin e cikleve të edukimit;
- Marrëveshjet institucionale për riintegrimin e të dënuarve, etj.

Dy nga parimet bazë të sistemit penitenciar konsistojnë në:

- Menaxhimin e kohës së ndalimit në mënyrë të tillë që të lehtësojnë ri-integrimin në një shoqëri të lirë të personave që iu është mohuar liria, si dhe
- Inkurajimi për bashkëpunime me shërbime të jashtme shoqërore dhe përfshirjen e shoqërinë civile në jetën e burgut.³⁰

Heqja e lirisë është një dënim në vetvete dhe si rezultat, regjimi për të burgosurit nuk mund të përkeqësoj vuajtjen e vetë burgimit. Qëllimi i këtyre standardeve konsiston në, evidentimin e programeve arsimore dhe trajnimeve profesionale të tilla që, pas lirimit individit të integrohet lehtësisht në sistemin arsimor dhe profesional të vendit, duke i mundësuar zhvillim të mëtejshëm. Produktet e zbatimit të këtyre iniciativave, grupi i auditimit gjykoj ti vlerësoj nëpërmjet metodologjisë së hartimit të planeve individuale të trajnimit në harmoni me punën sociale dhe kujdesin psikologjik për të dënuarit. Referuar legjislacionit në fuqi³¹, të paraburgosurit apo të dënuarit, që nuk kanë përfunduar arsimin nëntëvjeçar, i krijohen kushte për përfundimin e tij me anë të një programi të veçantë, të miratuar nga ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit.

Gjetje

1. Gjatë fazës së terrenit grupi i auditimit u njoh me dokumentacionin e IEVP-ve ku rezultoi se: IEVP Vlorë dhe IEVP Peqin në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. 526 Prot, date 17.01.2018 dhe nr. 729, date 18.01.2018 e lidhur mes Ministrisë së Drejtësisë dhe MASR, ushtrojnë procesin arsimor, ndërsa në IEVP Rrogozhinë, grupit të auditimit nuk iu vendos asnjë evidencë mbështetëse si Regjistra dhe foto të zhvillimit të procesit mësimor.
2. Njëkohësisht grupi i auditimit kërkoj informacione mbështetëse prej DPB mbi marrëveshjet dhe programet e miratuar trajnuese dhe profesionale të cilët u përgjigjën se : marrëveshja e bashkëpunimit për formimin profesional të burgosurve është në proces ri-shikimi.
3. Për të bazuar opinionin auditues si evidencë mbështetëse, grupi i auditimit gjatë zhvillimit të intervistave me përfituesit e shërbimit të IEVP-ve, konkretisht me të paraburgosur dhe të dënuar, rezultoi se: shumica e tyre nuk kanë qenë pjesë e programeve trajnuese, sikurse nuk kanë as dijeni mbi kryerjen e kurseve profesionale për zhvillimin e aftësive. Rregullisht ata ndjejnë frymën e bashkëpunimit të organizatave fetare të cilat iu mundësojnë predikimin e rriteve fetare në regjimin e brendshëm.

Në funksion të rehabilitimit dhe integritetit, gjatë fazës së terrenit grupi i auditimit iu vendosën në dispozicion prej IEVP Peqin dhe IEVP Vlorë fillimisht Urdhër nr.855, datë 29.01.2016 “Për miratimin e indikatorëve dhe objektivave të matjes së performancës në IEVP”, si dhe disa marrëveshje bashkëpunimi me objekt: arsimin e detyrueshëm për të dënuarit, pjesëmarrjen në ritualet fetare, trajnime profesionale zhvillimi dhe qendra e këshillimit.

Gjetje

4. Për secilën prej evidencave të siguruara nga subjekti IEVP Vlorë dhe IEVP Peqin mbi rehabilitimin dhe integrimin e të dënuarve grupi konstatoj se, marrëveshjet e bashkëpunimit

³⁰ Rekomandim (2006) 2 mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve

³¹ Vendimi nr. 437, datë 20.5.2015 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”, neni 60



përveçv afatit të vlefshmërisë nuk citojnë pikën e kontakti, afate për dërgim raporte narrative, raporte analitike apo dokumentacioni tjetër justifikues

Konkluzione

- Për periudhën objekt auditimi subjektet kanë vënë në përdorim disa marrëveshje me objekt edukimin dhe arsimin e detyrueshëm të paraburgosurve dhe të dënuarve. Megjithatë zbatimi i këtyre marrëveshjeve, nuk përmbush detyrimin e institucioneve përgjegjëse të sistemit penitenciar lidhur me zhvillimin efektiv të trajnimeve³². Kjo nuk është arritur sepse nuk janë marrë parasysh në vazhdimësi nevojat individuale të paraburgosurve dhe të dënuarve për t'u trajnuar në ato profile ku ata kanë mangësi apo dhe vetë tregu i punës orientohet, në mënyrë që riintegrimi i tyre të jetë eficient dhe recidivizmi të ulët ndjeshëm.
- Realizimi i numrave me të burgosur të angazhuar në trajnime, projekte të OJF-ve apo kurse profesionale, për aq kohë sa vetë të dënuarit nuk e pohojnë një gjë të tillë, mund të plotësoj veç rreshta e regjistrave, por kurrësi nuk përmbush objektivat mbi rehabilitimin e të dënuarve, duke zbehur mundësinë e riintegrit të mëpasshëm të tyre në shoqëri.

Rekomandime

1. IEVP Rrogozhinë në bashkëpunim me institucionet rajonale arsimore, të marri masa për të bërë efektive marrëveshjet ndër-institucionale në kuadër të zhvillimit të procesit arsimor në burg për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Brenda 6-mujorit të parë të 2021

Në lidhje me këtë rekomandim, Ministria e Drejtësisë në observacionet e paraqitura me e-mail, datë 19.01.2021, për këtë konstatim të grupit të auditimit, është shprehur se: *DPB vazhdon të ketë marrëveshje bashkëpunimi për arsimimin e të burgosurve me orientim të veçantë arsimin e detyruar, gjithashtu kemi marrëveshje edhe për kualifikimin profesional. Në kuadër të hartimit të akteve të reja nënligjore, kemi përfunduar dy projekt marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, të cilat do të finalizohen së shpejti. Gjithashtu vlen të thuhet se në vitin 2019 në IM Kavajë, u ngrit edhe klasa për zhvillimin e arsimit të mesëm me mbështetjen e Drejtorisë Rajonale të Arsimit, Kavajë. Shpjegimi i subjektit na njeh me masat pozitive të marra në këtë kuadër, por jo me zbatimin në terren të tyre të cilat grupi i auditimit i ka përmenduar në shtjellim të materialit. Megjithatë grupi vlerëson se komentit shpjegues i MD nuk ofron argumenta shtesë mbi konstatimin, si e tillë nuk kundërshton rekomandimin.*

2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të hartoj modalitete mbi ndjekjen reale të marrëveshjeve ndër-institucionale me objekt arsimimin dhe trajnimet e vazhdueshme profesionale të paraburgosurve dhe të dënuarve në IEVP, si dhe të hartoj databazën e të dënuarve që kanë zhvilluar këto programe.

Brenda vitit 2021

Në bazë të akteve ligjore në fuqi³³, administrata e IEVP-së nxit dhe krijon kushtet për formimin profesional brenda dhe jashtë institucionit të tilla që ciklet e trajnimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve të synojnë rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Kjo përgatitje për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit

³² Ligj Nr.8328, Datë 16.4.1998 Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve, i ndryshuar

³³ Ligj Nr.8328, Datë 16.4.1998 Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve, i ndryshuar



dhe pas lirimit nga burgu. Përmbushja e këtij detyrimi, realizon misionin primar të vetë sistemit penitenciar atë të riintegritit shoqëror dhe social të individëve dhe uljen e recidivizmit.

Gjetje

5. Grupi i auditimit nga dokumentacioni mbështetës prej IEVP Peqin dhe IEVP Vlorë konstaton se: për periudhën objekt auditimi, numri mesatar i individëve të cilët kanë kryer më parë vepra penale dhe kanë vuajtur me parë dënim penitenciar është i lartë.

Konkretisht po e ilustruam në tabelën më poshtë:

Tabela 14 – Numri i individëve përsëritës

	IEVP Vlorë					IEVP Peqin			
	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019
Janar	3	9	9	1	3	5	0	2	2
Shkurt	2	7	13	4	11	5	3	2	2
Mars	5	6	0	4	4	1	2	0	5
Prill	4	5	4	5	1	5	1	0	3
Maj	4	11	4	29	3	2	2	0	2
Qershor	7	6	1	3	10	7	5	4	2
Korrik	5	7	3	2	5	4	2	5	2
Gusht	4	4	1	1	4	6	1	9	0
Shtator	2	6	0	2	2	4	6	0	0
Tetor	1	6	2	1	0	3	2	0	0
Nëntor	4	6	1	2	0	2	4	0	1
Dhjetor	3	5	0	1	0	1	2	0	0
TOTALI	44	78	38	55	43	45	30	22	19

Gjetje

6. Vetëm për vitet 2016 dhe 2017 në IEVP Vlorë kanë qënë respektivisht 44 dhe 78 persona recidivist, ndërsa për IEVP Peqin kanë qënë 45 recidivist për vitin 2016 dhe 30 persona për 2017.

Praktikat e vendeve të rajonit si rasti i Republikës së Kosovës³⁴ në përfshirjen e arsimit cilësor në programet e riedukimit dhe risocializimit, ofrojnë një shembull alternativ dhe referues për sistemin tonë penitenciar.

Konkluzione

- Pavarësisht përpjekjeve të IEVP-ve për të realizuar trajnime në përmbushje të misionit të riintegritit të të dënuarve dhe uljes së recidivizmit, shifrat e larta të analizuar në subjektet e auditimit shfaqin nivele të ulëta efieciencie dhe mungesë efektiviteti për formën e hartimit, zhvillimit dhe ndjekjes së trajnimeve edukuese.
- Kontributet e organizatave jofitimprurëse dhe individëve të veçantë janë praktika trajnimi dhe edukimi të cilat qëndrojnë si evidenca në administratën e IEVP-ve, por mos riaktivizimi dhe lënia në harresë, jo vetëm ul cilësinë e shërbimit të burgjeve, por njëkohësisht shfaqin inefektivitet në ofrimin e shërbimit për të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Rekomandime

³⁴ <https://shkk.rks-gov.net/home>



3. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me IEVP-të, të kujdeset për të mundësuar trajnime dhe kualifikime të veçanta në fushat përkatëse, duke monitoruar procesin dhe përmbajtjen e kurikulave të trajnimit në vazhdimësi.

Brenda muajit Mars 2021 dhe në vazhdimësi

4. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me IEVP-të, të orientojnë praktikatat e programeve të individualizuara profesionale drejt modeleve ndërkombëtare dhe metodave interaktive.

Brenda muajit Mars 2021 dhe në vazhdimësi

Në lidhje me tre rekomandimet e fundit, Ministria e Drejtësisë në observacionet e paraqitura me e-mail, datë 19.01.2021, për këto konstatime të grupit të auditimit, është shprehur se: *Kohët e fundit është miratuar nga DPB dhe dërguar pranë IEVP praktika e plotë e hartimit të planit individual të dënimit, të vlerësimit të rrezikshmërisë, plane të ndërhyrjes etj. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, gjatë vitit 2019-2020 është përballur me dy situata të fatkeqësisë natyrore, tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia, të cilët kanë imponuar masa shtesë dhe angazhim të fondeve, pajisjeve dhe burimeve njerëzore për përballimin e tyre, garantimin e rendit e sigurisë në burgje, menaxhimin e të dënuarve në kushtet e reduktimit të ndërveprimit social dhe mbështetjen e inkurajimin e stafit për të përmbushur detyrat. Nga menaxhimi në situatat emergjente, është fituar një eksperiencë e mirë dhe janë evidentuar vlera si përkushtimi, gatishmëria, qëndresa e stafit për të përmbushur detyrat dhe gjithashtu bashkëveprimi dhe mirëkuptimi nga ana e të burgosurve lidhur me masat që janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për parandalimin e COVID-19. Shpjegimi i subjektit shprehet për veprime jashtë fokusit dhe periudhës së auditimit. Megjithatë grupi vlerëson se komentit nuk kundërshton rekomandimet, por paraqet masat që janë marrë dhe do të merren për zbatimin e tyre. Efekti i masave të mësipërme mund të vlerësohet nga një auditim vijues për zbatimin e rekomandimeve.*



4. PËRMBLEDHJE

4.1 Përmbledhje e konkluzioneve dhe rekomandimeve

Në këtë auditim, grupi synoi të vlerësonte politikat shtetërore për mirëqeverisjen e shërbimit të IEVP-ve ndaj kategorisë shoqërore të dënuar dhe në paraburgim, si dhe veprimtarinë e institucioneve përgjegjëse për të siguruar mekanizmat e menaxhimit, administrimit dhe monitorimit të shërbimit kundrejt kostos efektive e tij.

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjektet e përfshira dhe kuadrin ligjor e rregullator të fushës, gjykoj si më të përshtatshme për arritjen e objektivave të auditimit qasjen pragmatike, pra një ndërthurje midis qasjes sasiore dhe asaj cilësore.

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, grupi i auditimi u përpoq t'i jepte përgjigje pyetjes kryesore: **“A është efektiv shërbimi i IEVP-ve në Shqipëri për periudhën 2016-2019?”** dhe në përfundim u arrit në këtë mesazh auditimi:

KLSH konstaton se, rritja e pozicioneve vakante në sistemin e burgjeve dhe rrjedhimisht rritja e ngarkesës së punës për punonjësit aktual ul eficiencën e shërbimit të këtij sistemi. Diferencimi në statusin e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe atij të Policisë së Burgjeve e ka bërë më pak të preferuar këtë të fundit. Kjo ka ndodhur si pasojë e kushteve të vështira në arsimim dhe kualifikim, shpërblim dhe logjistikë për Policinë e Burgjeve. Ndërsa, përdorimi i komandimit në detyrë në mënyrë të vazhdueshme nuk motivon drejtuesit e IEVP-ve, duke ndikuar edhe në eficiencën e punës.

Akti i fundit që rregullon shpërblimin e të dënuarve daton që në vitin 1993, shumë kohë përpara miratimit të vetë ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve. Kjo ka bërë që puna në IEVP të konsiderohet si një mjet për të përfutur uljen e ditëve nga dënimi dhe jo një mjet për të siguruar të ardhura. Heqja e lirisë është një dënim në vetvete dhe si rezultat, regjimi për të burgosurit nuk mund të përkeqësoj vuajtjen e burgimit me infrastruktura të amortizuara dhe ushqyerje jo të shëndetshme. Pavarësisht përpjekjeve të IEVP-ve për të realizuar trajnime në përmbushje të misionit të riintegrit të të dënuarve, shifrat e larta të recidivistëve shfaqin mungesë efektiviteti për formën e hartimit, zhvillimit dhe ndjekjes së trajnimeve edukuese.

Për pyetjen 3.1.1:

Rritja e pozicioneve vakante në sistemin e burgjeve dhe rrjedhimisht rritja e ngarkesës së punës për punonjësit aktual ul eficiencën e shërbimit të këtij sistemi, duke qenë se shërbimi duhet të mbulojë të gjitha orët e ditës, ndërkohë që burimet në dispozicion janë të kufizuara. Konkretisht, kjo përkthehet në ulje të cilësisë së shërbimit.

Mos përfitimi i statusit të nëpunësit civil nga punonjësit e Policisë së Burgjeve e ka bërë më pak tërheqës këtë të fundit në drejtim të aplikimeve për vende pune nga individët.

Krahas mbështetjes financiare të ofruar nga shteti, përmirësimi i aspektit arsimor, trajnues dhe trajtimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve është shumë i rëndësishëm për rritjen e efektivitetit të shërbimit në IEVP. Cilësia e shërbimit rritet në raport të drejtë me rritjen e kualifikimit të punonjësve dhe njëkohësisht nxit rritjen e kërkesës për aplikim në Policinë e Burgjeve.

Komandimi është parashikuar të jetë një mjet i përkohshëm për të zgjidhur ngërçe në situata të veçanta. Përdorimi i tij në mënyrë të vazhdueshme nuk motivon drejtuesit, të cilët ndihen me statusin e ‘të përkohshmit’ në një pozicion të caktuar, duke ndikuar edhe në eficiencën e punës.



Rekomandime

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masat e nevojshme për të mbuluar mungesat e krijuara nga pozicionet vakante në stafin e IEVP-ve, nëpërmjet rekrutimit të burimeve të reja apo rialokimit të atyre ekzistuese.

Deri në Qershor 2021

- Ministria e Drejtësisë, me asistencën e Drejtorisë së Burgjeve apo në bashkëpunim me institucione të tjera, të shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të procesit të pranimit në Policinë e Burgjeve, në linjë me procesin e aplikuar nga Policia e Shtetit (nëpërmjet një institucioni si Akademia e Sigurisë), me qëllim të mëtejshëm ndryshimin e statusit dhe nivelit të kualifikimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve në linjë me ata të Policisë së Shtetit.

Deri në Qershor 2021

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të propozojë pranë Ministrisë së Drejtësisë emrat për drejtues të IEVP-ve, me qëllim emërimin e tyre, duke e ruajtur komandimin si një mjet të përkohshëm për situata të caktuara.

Deri në Qershor 2021 dhe në vazhdimësi

Për pyetjen 3.1.2:

Mungesa e theksuar e investimeve infrastrukturore për periudhën objekt auditimi, e cila ofron mosrespektim të kushteve minimale të fjetjes, ushqimit, pushimit dhe atyre higjieno sanitare në IEVP Rrogozhinë, jo vetëm që nuk përmbush detyrimet e legjislacionit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare, por njëherësh ul dinjitetin e të dënuarve që ushtrojnë ekzekutimin e veprës penale në këtë burg, duke ofruar shërbime që cenojnë efektivitetin institucional.

Mungesa e sigurimit të dietës ushqimore e cila nuk merr parasysh moshën e të dënuarve, shëndetin, kushtet fizike, fenë, kulturën dhe natyrën e punës që kryejnë, si dhe mos përditësimi i saj që prej viti 2006, ofron thjesht ofrimin e tre vakteve ushqimore për të dënuarit, por jo ushqyerjen e shëndetshme të tyre. Mungesa e ujit të pijshëm në IEVP për të dënuarit, cenon të drejtën themelore të tyre, duke provokuar njëherësh shpenzime monetare në njësinë tregtare.

Vetëm ekzistenca fizike e ambienteve të ndërveprimit social, pa plotësuar kushtet didaktike të vendosjes së tyre në funksion të të dënuarve, nuk sjellë përmbushje të detyrimit institucional të IEVP-ve. Efektiviteti i realizimit të shërbimit të burgjeve vlerësohet në harmoni me balancimin e plotësimit jo vetëm të utilitetit fjetje dhe ushqim, por edhe në konsideratën financiare që i atribuohet sallave të lojërave, ambienteve familjare të dhomave të prindërimit, dhomave të kompletuara të kujdesit shëndetësor brenda burgjeve si edhe bibliotekave të pasura.

Rekomandime

- Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Rrogozhinë të hartojnë planin e masave për respektimin e kushteve infrastrukturore sipas standardeve të legjislacionit në fuqi dhe në harmoni me ato ndërkombëtare.

Brenda muajit Mars 2021

- Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të rishikojnë normën ushqimore të të dënuarve ku të parashikojnë moshën e të dënuarve, shëndetin, kushtet fizike, fenë, kulturën dhe natyrën e punës që kryejnë si dhe në respektim të rekomandimeve të Këshillit të Evropës mbi rregullat e burgjeve.

Brenda 6-mujorit të parë të 2021



- Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Peqin, Rrogozhinë dhe Vlorë të sigurojnë ujin e pijshëm për të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Brenda 6-mujorit të parë të 2021

- IEVP-të Peqin, IEVP Rrogozhinë dhe IEVP Vlorë të marrin masa për të kompletuar bibliotekat me literaturën bazë për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, legjislacionin bazë penal, procedural penal³⁵ si dhe të pasurojnë përmbajtjen e titujve shkencor dhe artistik.

Brenda 6-mujorit të parë të 2021

- IEVP-të Peqin, IEVP Rrogozhinë dhe IEVP Vlorë të marrin masa për të kompletuar ambientet e përbashkëta, ambientet sportive dhe dhomat e prindërimit, me pajisjet didaktike për vendosjen në funksion të tyre si dhe mjetet e nevojshme të komunikimit më zyrtar korrespondente të avokatit të popullit, të tillë që të përafrojnë jetën në burg sa më shumë që të jetë e mundur me aspektet pozitive të jetës në komunitet.

Brenda 6-mujorit të parë të 2021

Për pyetjen 3.2.1:

Punësimi në subjekte të tjera jashtë ambienteve të institucionit mund të ndihmojë të dënuarit profesionalisht, për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri dhe për më tepër, mund t'i ndihmojë ata për të siguruar të ardhura për veten apo familjen.

Duke mbajtur parasysh të gjitha ndryshimet e vlerës së monedhës shqiptare gjatë këtyre 3 dekadave, shpërblimi mujor për të dënuarit e punësuar mund të konsiderohet i papërfillshëm.

Pagesa jo e duhur, mos njohja e vjetërsisë së punës dhe mos pagimi i sigurimeve shoqërore përbën shkelje të Ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, i ndryshuar “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe Rregullave Evropiane të Burgjeve.

Rekomandime

- Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, së bashku me IEVP-të përkatëse të nxisin punësimin e të dënuarve në subjekte të tjera jashtë institucionit ku vuajnë dënimin, nëpërmjet fushatave promovuese, marrëveshjeve të bashkëpunimit, etj.

Deri në Qershor 2021 dhe në vazhdimësi

- Ministria e Drejtësisë të bëjë përditësimin e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 2259, datë 11.03.2008, duke reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur ndër vite në sistemin e burgjeve.

Deri në Qershor 2021

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, së bashku me IEVP-të përkatëse të ngrenë një sistem më eficient për monitorimin e punës faktike të të dënuarve dhe llogaritjen përkatëse të ditëve të punës.

Deri në Qershor 2021 dhe në vazhdimësi

- Ministria e Drejtësisë të propozojë pranë Këshillit të Ministrave ndryshimin e VKM nr.228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”, në mënyrë që të sigurohet një pagesë e duhur për të dënuarit e punësuar.

Deri në Qershor 2021

³⁵ Vendimi nr. 437, datë 20.5.2015 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”, neni 59



Për pyetjen 3.2.2:

Për periudhën objekt auditimi subjektet kanë vënë në përdorim disa marrëveshje me objekt edukimin dhe arsimin e detyrueshëm të paraburgosurve dhe të dënuarve. Megjithatë zbatimi i këtyre marrëveshjeve, nuk përmbush detyrimin e institucioneve përgjegjëse të sistemit penitenciar lidhur me zhvillimin efektiv të trajnimeve³⁶. Kjo nuk është arritur sepse nuk janë marrë parasysh në vazhdimësi nevojat individuale të paraburgosurve dhe të dënuarve për t'u trajnuar në ato profile ku ata kanë mangësi apo dhe vetë tregu i punës orientohet, në mënyrë që riintegrimi i tyre të jetë eficient dhe recidivizmi të ulët ndjeshëm.

Realizimi i numrave me të burgosur të angazhuar në trajnime, projekte të OJF-ve apo kurse profesionale, për aq kohë sa vetë të dënuarit nuk e pohojnë një gjë të tillë, mund të plotësoj veç rreshta e regjistrave, por kurrsesi nuk përmbush objektivat mbi rehabilitimin e të dënuarve, duke zbehur mundësinë e riintegrit të mëpasshëm të tyre në shoqëri.

Pavarësisht përpjekjeve të IEVP-ve për të realizuar trajnime në përmbushje të misionit të riintegrit të të dënuarve dhe uljes së recidivizmit, shifrat e larta të analizuara në subjektet e auditimit shfaqin nivele të ulëta efience dhe mungesë efektiviteti për formën e hartimit, zhvillimit dhe ndjekjes së trajnimeve edukuese.

Kontributet e organizatave jofitimprurëse dhe individëve të veçantë janë praktika trajnimi dhe edukimi të cilat qëndrojnë si evidenca në administratën e IEVP-ve, por mos riaktivizimi dhe lënia në harresë, jo vetëm ul cilësinë e shërbimit të burgjeve, por njëkohësisht shfaqin ineffektivitet në ofrimin e shërbimit për të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Rekomandime

- IEVP Rrogozhinë në bashkëpunim me institucionet rajonale arsimore, të marri masa për të bërë efektive marrëveshjet ndërinstitutionale në kuadër të zhvillimit të procesit arsimor në burg për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Brenda 6-mujorit të parë të 2021

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të hartoj modalitete mbi ndjekjen reale të marrëveshjeve ndërinstitutionale me objekt arsimimin dhe trajnimet e vazhdueshme profesionale të paraburgosurve dhe të dënuarve në IEVP, si dhe të hartoj databazën e të dënuarve që kanë zhvilluar këto programe.

Brenda vitit 2021

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me IEVP-të, të kujdeset për të mundësuar trajnime dhe kualifikime të veçanta në fushat përkatëse, duke monitoruar procesin dhe përmbajtjen e kurikulave të trajnimit në vazhdimësi.

Brenda muajit Mars 2021 dhe në vazhdimësi

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me IEVP-të, të orientojnë praktikat e programeve të individualizuara profesionale drejt modeleve ndërkombëtare dhe metodave interaktive.

Brenda muajit Mars 2021 dhe në vazhdimësi

³⁶ Ligj Nr.8328, Datë 16.4.1998 Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve, i ndryshuar



4.2 Anekse

Pyetësor për të paraburgosurit dhe të dënuarit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Rruga Abdi Toptani, nr.1, Tiranë; Tel-Fax: +355 4 2251267

E-mail: Klsh@klsh.org.al; Ëeb-site: ëëë.klsh.org.al

Drejtuar: Përfituesit e shërbimit të IEVP-ve

Për dijeni : Stafit drejtues së IEVP-së.

Lënda: Pyetësor për auditimin e performancës “Efektiviteti i shërbimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përmbushje të funksionit të vet kushtetues, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI dhe praktikat më të mira audituese në Europë e më gjerë, i orientuar drejt modernizimit dhe rritjes cilësore profesionale të kapaciteteve njerëzore, strukturore dhe teknike në të gjithë administratën publike, ka nisur, si pjesë të planit vjetor për 6-mujorin e dytë 2020, auditimin e performancës **“Efektiviteti i shërbimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”**.

Siç jeni njohur edhe nga programi, aktualisht auditimi ndodhet në fazën e terrenit. Gjatë kësaj faze grupi i auditimit, për marrjen e informacionit, ndër të tjera, ka përzgjedhur edhe metodën e intervistimit, bazuar në nenin 26 të Ligjit Nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” që i jep të drejtën për disponimin e informacionit zyrtar, si dhe të Manualit të Auditimit të Performancës miratuar me Vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku pyetësi parashikohet si një teknikë për grumbullimin e informacionit. Periudha nën auditim, për të cilën interesohen pyetjet e këtij dokumenti, është 01.01.2016-31.12.2019. Luten të intervistuarit që të gjenerojnë përgjigje objektive, të sinqerta dhe të mbështetura në eksperiencën e tyre.

Për çdo paqartësi që mund të krijohet, jeni të mirëpritur të komunikoni në adresat kanastas@klsh.org.al, mberdo@klsh.org.al.

Në lidhje me burimet njerëzore

1. Gjatë qëndrimit në IEVP a keni ndjerë nevojën e përdorimit të ambienteve mjekësore?
2. Nëse po a keni marrë shërbim në kohën e duhur?
3. Nëse keni pasur nevojë për medikamente, a jeni pajisur në kohë?
4. Gjatë qëndrimit në IEVP a keni ndjerë nevojën e konsultave me psikologun?
5. Nëse po a keni marrë shërbim?
6. A ka qenë korrekte sjellja e policëve të burgut gjatë qëndrimit tuaj në IEVP, si dhe gjatë shoqërimeve?

Në lidhje me kushtet infrastrukturore

1. Sa veta jeni në qeli?
2. Çfarë pajisjesh keni në qeli dhe çfarë pajisjesh ju mungojnë?



3. A jeni të kënaqur me trajtimin ushqimor? Nëse jo, citoni arsyet.
4. Sa shpesh i frekuentoni ambientet e edukimit, pushimit dhe argëtimit?
5. Sa shpesh dilni në bokset e ajrimit dhe sa gjatë qëndroni?
6. A merrni ushqime dhe veshmbathje prej familjarëve? Nëse po, sa shpesh?
7. A zhvilloni takime me familjarët? Nëse po, sa shpesh?
8. A shpenzoni në ambientin tregtar të IEVP-së? Nëse po, për çfarë artikujsh?

Në lidhje me programet e punësimit dhe të arsimit

1. Gjatë qëndrimit në IEVP a jeni pyetur mbi nivelin e arsimit dhe aftësive profesionale që keni?
2. A jeni njohur me mundësinë e punësimit në IEVP?
3. A jeni punësuar në ambientet e IEVP-së? Nëse po, për çfarë periudhe?
4. A keni marrë shpërblim për punën e kryer?
5. A ju është dhënë mundësia të shprehni nevojat tuaja për trajnime?
6. A janë zhvilluar trajnimet? Nëse po, në cilat ambiente? Nga kush jeni trajnuar?

5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE

1. Miranda Berdo, Përgjegjëse e grupit të auditimit
2. Krisi Anastas, Anëtar

DREJTOR I DEPARTAMENTIT ME AUTORIZIM

Aulent GURI